



RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021

Grupi i punës:

- Kryetari i komunës - Mehmet Ballazhi
- Nënkryetari i komunës - Sevdi Dernjani
- Zyra e personelit - Ajete Berisha
- Zyra ligjore - Bajrush Laçi
- Zyra e prokurimit – Xhevdet Bushi
- Zyra e informimit - Bashkim Sopa
- Zyrtari për të drejtat e njeriut, kundër diskriminimit dhe të drejtat e fëmijëve - Vjosa Livoreka Rogaçi
- Zyra për komunitete dhe kthim- Xhemshit Kalisi
- Drejtoreshë e drejtorisë për Administratë të Përgjithshme - Natyra Kalisi
- Drejtoreshë e drejtorisë për Buxhet dhe Financa - Lindita Ballazhi
- Drejtor i drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini e Sport - Hisni Luri
- Drejtor i drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - Nexhmedin Daci
- Drejtoreshë e drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –Kimete Kuka Hasallari
- Drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë – Arsim Dernjani
- Drejtoreshë e drejtorisë për Zhvillim Ekonomik – Majlinda Kaloshi
- Drejtor i drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Abdurraman Bushi

Përmbajtja

AKTIVITETET E KRYETARIT	4
ZYRA E PERSONELIT	5
ZYRA LIGJORE	7
ZYRA E PROKURIMIT	9
ZYRA PËR TRANSPARENÇË.....	15
ZYRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, FËMIJËVE DHE BARAZI GJINORE.....	16
ZYRA KOMUNALE PËR KTHIM DHE KOMUNITETE	17
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	18
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA JANAR-QERSHOR 2021.....	22
DREJTORIA PËR ARSIM , KULTURË , RINI DHE SPORT	46
DREJTORIA URBANIZËM KADASTËR DHE MBROTJE TË MJEDISIT	54
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	58
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË	71
DREJTORIA PËR BUJQËSI PYLLTARI DHE ZHVILL RURAL	77

AKTIVITETET E KRYETARIT

Për të raportuar nga gjashtë mujori i dytë i vitit 2021 nuk kam marrë asgjë nga kryetari paraprak dhe nuk më ka dorëzuar as një raport në lidhje me aktivitetet e tij gjatë kësaj periudhe. Me qenë se jemi qeverisje e re dhe në qeverisjen tonë e kemi vetëm një muaj raportim gjatë të cilave kemi zhvilluar vetëm vizita të qytetarëve dhe takime të punës javore me bordin e drejtorëve si dhe raportimet javore nga Drejtoritë. Detyrën si Kryetari i Komunës e kam pranuar me datë 26.11.2021.

Gjatë muajit të kaluar është bërë pranim dorëzimi i dy donacioneve nga Kontigjenti Italian i KFOR-IT.

Është funksionalizuar zyra për ndihmë juridike falas.

**Kryetar i Komunës,
z. Mehmet Ballazhi**

ZYRA E PERSONELIT

Në zyrën e personelit gjatë vitit 2021 janë kryer disa aktivitete, duke filluar nga kontrolli dhe evidentimi i prezencës në punë i gjithë punëtorëve, mirëmbajtjen e dosjeve, menaxhimin e pushimeve vjetore dhe pushimeve tjera, kërkesat dhe shkresat përcjellëse Ministrisë së Administratës Publike dhe institucioneve tjera, bashkëpunimi me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, njoftimin e punëtorëve rreth pushimeve dhe festave zyrtare, ndjekjen e trajnimeve, zbatimin e Ligjit për zyrtarët Publik.

Në mënyrë të rregullt dhe sistematike, nga Zyra e Personelit me anë të aparatit digjital, është bërë evidentimi i gjithë punëtorëve ku gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnjë rast vonese pa arsye.

Janë kompletuar dosjet e pushimit vjetor për vitin 2020.

Janë përgatitur 41 dosje të pushimit vjetor për vitin 2021.

Gjithashtu sipas evidencës që posedon zyra e Personelit dhe me kërkesë të vetë nëpunësve janë lëshuar:

- 4 vërtetime për mardhënie pune,
- 6 referenca të punës,
- 9 vendime mbi kompenzimin e pagesës së shpërblimit të përvjetorit jubile,
- 5 vendime për mëditje jashtë vendit,
- 3 vendime për njohjen e përvojës së punës,
- 3 vendime për transferimin dhe sistemimin e nëpunësve në listë të pagave,
- 2 vendim për caktimin e detyrave shtesë,
- 1 vendim për ndryshimin e titullit,
- 1 vendim për Pushim të Lehonisë,
- 2 kërkesa për mbledhjen e komisionit disiplinor,
- 2 përgjigje në Ankesë për nëpunësit e arsimit,
- 1 kërkesë për Drejtorin e Departamentit për menaxhimin e zyrtarëve publik për unifikimin e koeficientëve,
- 1 kërkesë për Drejtorin e Departamentit për menaxhimin e zyrtarëve publik për aprovim të koeficientëve,
- 1 shkresë për Drejtorin e Departamentit për menaxhimin e zyrtarëve publik rreth konkursit për Drejtor të Institucionit Parashkollor,
- 6 njoftime rreth ditëve të pushimit për festat zyrtare për gjithë nëpunësit civil,
- Raport i aktiviteteve të ndërmarra në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Gjithashtu është përgaditur plani vjetor i trajnimeve për nëpunësit civil i cili përcillet në MAP çdo fillim të vitit.

Janë vazhduar kontratat e punës për punëtorët teknik.

Nga zyra e personelit janë përgaditur 4 procedura përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për Lëvizje paralele në përputhje me Ligjin për zyrtarët Publik, të gjitha këto procedura janë publikuar në webfaqen e konkurrimeve dhe pas përfundimit të afatit për aplikim është përgatitur njoftimi për përfundimin e këtyre procedurave pa asnjë kandidat.

Pozitat për të cilat janë zhvilluar procedurat e Lëvizjes Paralele janë:

- Zyrtar për Bujqësi,
- Zyrtar për tatimin në pronë,
- Zyrtar për Emergjencë dhe
- Zyrtar për planifikim dhe zhvillim.

Është bërë publikimi i konkurseve të sektorit të arsimit dhe shëndetësisë në web-faqen e konkurremeve. Janë përgatitur raporte 3 mujore për DASHC-në rreth numrit, gjinisë dhe përkatësisë etnike të të punësuarve në komunën e Hanit të Elezit, nga sistemi i “Payroll” janë shkarkuar listat e pagave të cilat përcillen në drejtoritë përkatëse për t’u nënshkruar dhe kthehen përsëri në zyrën e Personelit ku arkivohen.

Gjithashtu në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive janë caktuar nëpunësit të cilët kanë ndjekur trajnime në Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe nga disa organizata tjera joqeveritare. Është përgatitur Plani i punës së Zyrës së Personelit për vitin 2022.

Është përgatitur Plani i Personelit për vitin 2022 në përputhje me planifikimet buxhetore i njëjti i është përcjell DMZP-së për aprovim. Janë përgatitur vendimet për ndërprerjen e mandatit për stafin politik.

Në mbështetje të Ligjit për Zyrtarët publik nr 06/L-114 dhe me bashkëpunimin e drejtorive për Arsim dhe Shëndetësi është përgatitur lista e të punësuarve me titujt e punës sipas kontratës apo aktemërimit dhe është bërë deklarimi i statusit të nëpunësit, kjo listë i është përcjellur DMZP për aprovim.

Trajnimet e zyrtarëve të ndryshëm gjatë gjashtë muorit 2021 janë:

- Puna me fëmijët,
- Supervizimi,
- Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e fëmijëve”,
- Sigurimet shëndetësore,
- Ri-integrimi i të rikthyerve nga vendet e luftës,
- Ligji për procedurën administrative,
- Trajnim për Menaxhimin e Cash-it,
- Menaxhimi i kontratës nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik dhe
- Zhvillimi i fëmijëve dhe faktorët e rrezikut që mund të ndikojnë në paraqitjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimi.

**Zyra Personelit,
Znj. Ajete Berisha**

ZYRA LIGJORE

Zyra ligjore është e radhitur në organogramin e komunës në zyrën e Kryetarit të Komunës, e cila gjatë vitit 2021 ka vazhduar punët dhe detyrat në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe udhëzimeve të tjera nga ana e eprorit, përkatësisht nga Kryetari i komunës dhe gjithashtu bashkëpunimin me Drejtorët e drejtorive dhe me zyrtarë të tjerë. Si zyre kemi bashkëpunuar me të gjithë sektorët e komunës kemi arritur që pajtueshmëria e akteve komunale të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Paraqesim numrin e akteve juridike të përpiluara gjatë vitit 2021. Në këtë zyrë gjatë periudhës së raportimit, janë përpiluar akte juridike të cilat do t'i shënojmë në tabelën e mëposhtme dhe do t'i krahasojmë me gjysëmvitin e kaluar:

Viti	Vendime	Përgjigje ne kërkesa	Përgjigje ne padi	Autorizime	Njoftime	Vërtetime	Rekomandime	Kërkesat në inst. qendrore	Kontratë mbi shërbimin	Përgjigje ne kërkesë auditorve
2020	150	10	6	27	3	0	1	1	2	0
2021	190	16	12	16	2	0	0	3	0	1
Dif.	+40	+4	+12	-11	-1			+2	+2	+1

Duke pasur parasysh pozitën dhe detyrat e zyrës ligjore të gjitha aktet juridike të lartshënuara kanë qenë të hartuara dhe të mbështetura në dispozitat e aplikueshme të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i komunës së Hanit të Elezit vitit 2021 ka miratuar vendime, akte juridike brenda fushës së kompetencës së tij të cilat do t'i paraqesim sipas muajve vijues dhe do t'a bëjmë krahasim me gjysmë vitin 2020, duke i specifikuar vendimet dhe rregulloret.

	Janar		Shkurt		Mars		Prill		Maj		Qershor		Korrik		Gusht		Shtator		Tetor		Nëntor		Dhjetor	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Vendime	6	4	5	6	-	4	2	3	4	1	1	1	2	6	2	5	3	-	5	2	3	4	4	1
Rregullore		1													2		1						2	

Nga kjo tabelë rezulton se gjatë vitit 2021 nga kuvendi i komunës së Hanit të Elezit janë miratuar gjithsej: 18 vendime, ndërsa në vitin 2020 janë miratuar 35 vendime.

Sa i përket vendimeve të miratuara zyra ligjore prej muajit Janar të vitit 2021 deri në muajin Dhjetor afatin e paraparë ligjor ka përcjell të gjitha vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit me shkresë përcjellëse në MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për shqyrtim të ligjshmërisë), të parapara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, vendimet janë cilësuar me efekt të plotë juridik dhe nuk kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin, (këtu duhet të ceket se MAPL nuk ka përcjellë konfirmimet për të gjitha aktet tona të miratuara, por vetëm për disa që kanë qenë në kompetencë të tyre).

Zyra ligjore përveç çështjeve juridike të sipërpërmendura merret edhe me përfaqësime juridike në Gjykata.

Gjatë vitit 2021 në komunën e Hanit të Elezit ka pasur padi të ndryshme, por më shumë kemi padi për vërtetim të pronësisë, si zyre ju kemi bërë përgjigje në padi dhe kemi përfaqësuar komunën në Gjykata. Gjithashtu pas marrjes së aktgjykimeve në shkallën e parë të gjykatës kemi bërë ankesa në gjykatën e shkallës së dytë. Vlen të theksohet se nga gjykata e shkallës së dytë janë prishur një numër i konsiderueshëm i aktgjykimeve. Gjithashtu gjatë vitit 2021 kanë filluar të parashtrihen edhe padi nga ana e punëtorëve të arsimit për pagesën e diferencës mujore të pagesë sipas kualifikimit.

Për të gjitha llojet e padive duke respektuar Ligjin për procedurën kontestimore kemi bërë prapësime procedurale me përgjigje në padi në afatin ligjor, përfaqësimin e tyre me autorizim nga ana e Kryetarit të Komunës sipas ftesave të Gjykatës.

Vlen të theksohet se për shkak të mos zbatimeve të vendimeve administrative, pas plotfuqishmërisë së tyre debitorëve kemi bërë propozim për përmbartimin e vendimeve përmes përmbartuesit privat.

Zyra ligjore ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal dhe atë të Administratës Publike, në fushën e ligjshmërisë të akteve Ligjore dhe nënligjore.

Kjo zyrë ka bërë pajtueshmërinë e akteve ligjore në Komunë nëpër sektorë dhe kemi dhënë disa komentime lidhur me dispozitat e Ligjeve, Rregulloreve apo Udhëzimeve Administrative.

Kemi pasur një punëtor me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me OSBE, ndërsa punëtorit të tjerë janë organizuar nëpërmes platformës digjitale me Zoom në distancë.

**Zyra ligjore,
z. Bajrush Laçi**

ZYRA E PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit ka zhvilluar procedurat e prokurimit konform Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Zyra e Prokurimit publik ka zhvilluar procedurat e prokurimit me vlera minimale, të vogla dhe të mesme dhe janë kryer në harmoni me ligjin në fuqi.

Bazuar në procedurat që ka zhvilluar zyra e prokurimit të Komunës Hani i Elezit, sipas udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi procedurat i ndajmë në procedura me vlera mbi 1,000.00 € dhe procedurat me vlera nën 1,000.00 €, sipas tabelareve.

Procedurat e prokurimit zhvillohen në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) dhe interpretimet ligjore të KRPP-së!

Me hyrjen në fuqi të prokurimit elektronik sipas Ligjit në fuqi çdo aktivitet i prokurimit zhvillohet përmes platformes elektronike (E-prokurimit) . Pra, të gjitha procedurat janë publike sipas LPP-së dhe RrUOPP-së dhe çdo procedurë është zhvilluar në harmoni me ligjin e LPP-se dhe Rregulloret në fuqi.

Të bashkangjitur gjeni tabelarët për prokurimet e zhvilluara.

Nr. i Prokurimit	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës (ne rast anulimi data e njoftimit për anulim)	Vlera e parashikuar e kontratës	Cmimi I kontrates se nenshkruar	Cmimi I aneks kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata
Numri rendor i prokurimit						
001	Botimi i vjetarit dhe materialit shtypes (banera, kese etj)	24.03.2021	€ 3,800.00	€ 2,660.00	€ 0.00	NTG. "BLENDI" OP
002	Furnizim me peme dhe perime - MINITENDER	06.04.2021	€ 1,800.00	€ 1,768.32	€ 0.00	SKANDI; DONI Product shpk
003	Zhbllokimi i gypave të kanalizimit	26.03.2021	€ 9,920.00	€ 9,765.00	€ 0.00	EURO-PLUS shpk
005	Furnizim me material higjienik	31.03.2021	€ 9,961.00	€ 7,600.05	€ 0.00	LANTI PLAST shpk
006	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	29.03.2021	€ 9,940.00	€ 7,979.90	€ 0.00	BM Group shpk
007	Shërbime të veçanta - konsulente	14.04.2021	€ 2,000.00	€ 1,980.00	€ 0.00	Adnan Lusnjani
008	Rregullimi i ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale	10.06.2021	€ 9,999.00	€ 9,751.00	€ 0.00	RISAMONT shpk
009	Furnizim me material për mirëmbajtje	18.05.2021	€ 9,950.00	€ 9,102.11	€ 0.00	ELTELLA
010	Ndërtimi i rezervuarit të ujësjellsit - Gorancë	30.06.2021	€ 24,990.00	€ 21,845.78	€ 0.00	Kushtrimi - NM
011	Furnizim me pajisje sportive për nevoja të shkollave	28.07.2021	€ 9,994.00	€ 9,994.00	€ 0.00	SPORTING
012	Shpenzime interneti	31.08.2021	€ 7,900.00	€ 8,105.00	€ 0.00	ELEKTRA
013	Asfaltimi i rrugës DARDANIA - Hani i Elezit	29.07.2021	€ 55,316.00	€ 47,452.49	€ 0.00	RAHOVICA COMERCE
014	Shtrim me kubëza në zonën urbane dhe rurale - LOT 1	11.08.2021	€ 59,928.00	€ 43,501.35	€ 0.00	Kema Company
014	Shtrim me kubëza në zonën urbane dhe rurale - LOT 2	11.08.2021	€ 49,979.00	€ 36,514.90	€ 0.00	Kema Company
015	Blerja e pajisjeve për kabinete biologji, kimi - LOT 1	12.08.2021	€ 10,425.00	€ 8,666.00	€ 0.00	ABETARE
015	Blerja e pajisjeve për kabinete biologji, kimi - LOT 2	12.08.2022	€ 4,530.00	€ 4,208.00	€ 0.00	PROMEDICAL
016	Shërbime të byfes	29.07.2021	€ 9,997.50	€ 9,951.50	€ 0.00	DPH SAFETI
017	Rregullimi i infrastrukturës shkollë - LOT 1 (Rregullimi i parkingut të SHML. Dardania)	23.09.2021	€ 6,734.00	€ 5,651.80	€ 0.00	DANI COMPANY
017	Rregullimi i infrastrukturës shkollë - LOT 2 (Montimi i roletave të çerdhja)	28.09.2021	€ 3,215.00	€ 2,920.00	€ 0.00	MAZREKU
018	Servisimi i veturave të komunës dhe QKMF-së - LOT 1	27.08.2021	€ 6,500.00	€ 3,754.80	€ 0.00	SHPEND SEJDIU B.I

018	Servisimi i veturave të komunës dhe QKMF-se - LOT 2	27.08.2021	€ 3,350.00	€ 811.40	€ 0.00	SHPEND SEJDIU B.I
019	Kanalizimi në rrugën Elham Curri	29.09.2021	€ 20,000.00	€ 16,860.24	€ 0.00	ATC COM
020	Furnizim me dru për nevoja të shkollave	14.10.2021	€ 9,240.00	€ 9,020.00	€ 0.00	AOME
021	Furnizim me medikamente	12.08.2021	€ 9,989.00	€ 8,987.00	€ 0.00	AGANI LTD
022	Rregullimi i infrastrukturës në QKMF (ngrohja qendrore në QKMF)	08.10.2021	€ 73,377.00	€ 44,342.50	€ 0.00	Termovisioni & Arhiko Ing
023	Sigurimi i automjeteve të institucioneve komunale	24.09.2021	€ 8,500.00	€ 7,112.57	€ 0.00	EUROSIG
024	Riparimi i rrugeve dhe trotuareve	27.09.2021	€ 5,000.00	€ 4,723.00	€ 0.00	Berisha Company
025	Transporti i nxënësve - LOT 2	15.09.2021	€ 7,030.00	€ 6,845.00	€ 0.00	EUROTURS
025	Transporti i nxënësve - LOT 3	15.09.2021	€ 5,832.00	€ 5,832.00	€ 0.00	EUROTURS
025	Transporti i nxënësve - LOT 4	15.09.2021	€ 2,885.00	€ 2,880.00	€ 0.00	EUROTURS
026	Hartimi i projekteve - RITENDERIM	30.12.2021	€ 9,800.00	€ 9,800.00	€ 0.00	Studio Hapsira
027	Rregullimi i varrezave të qytetit	19.10.2021	€ 9,999.00	€ 8,828.80	€ 0.00	MAZREKU
028	Shpuarja i puseve për nxjerrjen e ujit	anulohet				
029	Furnizim me pajisje të IT-së MINITENDER	08.10.2021	€ 1,000.00	€ 1,111.40	€ 0.00	ARITECH
030	Transporti i nxënësve të SHFMU. Ilaz Thaçi	05.10.2021	€ 7,400.00	€ 7,307.50	€ 0.00	ARDI TOURS
031	Furnizim me dru për komunë, QKMF dhe çerdhe	20.10.2021	€ 9,660.00	€ 10,250.00	€ 0.00	AOME SHPK
032	Rregullimi i kanalizimit në zonën rurale (fsh.Seçishte dhe Gorancë)	19.11.2021	€ 3,061.75	€ 2,955.15	€ 0.00	ATC COM
033	Furnizim me material për laboratorin e QKMF-së	10.11.2021	€ 9,984.00	€ 8,645.00	€ 0.00	Genius Kosova
034	Shërbime shtypi për nevoja të komunës	13.01.2022	€ 8,700.00	€ 5,426.68	€ 0.00	STARGRAF
			€ 511,686.25	€ 414,910.24	€ 0.00	
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA					414,910.24	

PROCEDURAT PËR VLERAT MBI 1,000 €

VLERAT NËN 1,000.00 €

Nr.i Prokurimit						
Numri rendor i prokurimit	Titulli i aktivitetit të prokurimit	kontratës (ne rast anulimi data e njoftimit për anulim)	Vlera e parashikuar e kontratës	kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	të gjitha taksat etj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata
001	Furnizim me material higjienik për nevoja të administratës komunale	04.02.2021	€ 997.50	€ 978.00	€ 0.00	Islam Curri B.I.
002	Sigurimi dhe regjistrimi i veturës Toyota Prado	04.02.2021	€ 530.00	€ 515.93	€ 0.00	Ks. KOSOVA E RE
003	Riparimi i veturës Hyundai ix35	10.02.2021	€ 534.00	€ 498.20	€ 0.00	Hyunday Auto shpk
004	Furnizim me dollap për kabinetin Kimi - Biologji SHML. Dardania - H.Elezit	16.02.2021	€ 998.00	€ 990.00	€ 0.00	Exclusive Frasheri Center
005	Shërbime të publikimit në MTV dhe Web faqe për prezantim të aktiviteteve komunale	01.03.2021	€ 980.00	€ 960.00	€ 0.00	Dielli Media shpk
006	Furnizim me libra Fenikset e Lirisë	10.03.2021	€ 280.00	€ 240.00	€ 0.00	Radio Kosova e Lire
007	Furnizimi dhe montimi i kamerave SHFMU. Ilaz Thaçi	24.03.2021	€ 680.00	€ 670.05	€ 0.00	Elektra L.L.C
008	Furnizimi dhe montimi me perde për SHML. Dardania	10.03.2021	€ 837.20	€ 800.80	€ 0.00	Bashkim Dema B.I
009	Akomodimi i asambleistëve komunal brenda vendit në Rugovë	11.03.2021	€ 999.00	€ 998.00	€ 0.00	Magra shpk
010	Furnizim me tavoline ping- pongu për SHFMU. "Kështjella e Diturisë" - Paldenicë	15.06.2021	€ 290.00	€ 290.00	€ 0.00	Fatmir Godeni B.I.
011	Furnizim me TV për nevoja të kabineteve mësimore SHML. Dardania	22.03.2021	€ 998.00	€ 998.00	€ 0.00	GAMA shpk
012	Servisimi i veturës Hyundai i35 dhe i20	28.04.2021	€ 631.20	€ 622.55	€ 0.00	Hyundai Auto shpk
013	Servisimi i veturës Kia Sportage	01.06.2021	€ 996.40	€ 973.14	€ 0.00	AGS shpk
014	Furnizim me uniforma pune për nevoja të sigurimit fizik të komunës	26.05.2021	€ 997.00	€ 990.00	€ 0.00	Igballe Thaqi B.I
015	Furnizim me kosë bari për SHFMU. Ilaz Thaçi	02.06.2021	€ 860.00	€ 860.00	€ 0.00	Arsim Nuredini B.I
016	Furnizim me lule	22.06.2021	€ 995.00	€ 992.25	€ 0.00	Lulishtja ASIMI

017	Furnizim me maica me mbishkrim mirënjohje, fotografi për Javën kulturore - Diten e Çlirimit	09.06.2021	€ 997.50	€ 990.00	€ 0.00	FSC Dernjani
018	Furnizim me material sportiv për javën kulturore	09.06.2021	€ 597.00	€ 559.00	€ 0.00	Vlera Sport
020	Furnizim me mjete sportive për SHML. Dardania H.Elezit	08.07.2021	€ 998.00	€ 995.50	€ 0.00	Sporting
021	Larja e veturave të QKMF-se, komunës, zjarrfikësve	01.07.2021	€ 994.60	€ 986.00	€ 0.00	Autolarje Alba
022	Raparimi i kamionit të zjarrfikësve	14.07.2021	€ 998.00	€ 995.00	€ 0.00	Autoservis "AGRONI"S H.P.K.
023	Furnizim dhe servisim i klimave në administratën komunale	19.07.2021	€ 998.00	€ 995.00	€ 0.00	Arben Latifi B.I.
024	Furnizim dhe montim me polic të shtrirë	16.08.2021	€ 995.00	€ 960.00	€ 0.00	Sinjal SHPK.
025	Furnizim me material për DDD	07.09.2021	€ 814.00	€ 804.00	€ 0.00	Besim A.Zejnullahu B.I.
026	Furnizim me karriga për femijë dhe tavolina të rrumbullakta	07.09.2021	€ 997.50	€ 990.00	€ 0.00	Exkluzive freasheri center
027	Furnizim dhe montim i kamerave tek SHFMU.K.Diturisë	14.09.2021	€ 702.75	€ 702.75	€ 0.00	Elektra L.L.C.
028	Servisimi i kamerave nëpër qytet	11.10.2021	€ 993.50	€ 989.50	€ 0.00	Elektra L.L.C.
030	Zërimi i sallës së sporteve të SHFMU."I.Thaçi"	20.10.2021	€ 990.00	€ 986.00	€ 0.00	Elektra L.L.C.
031	Furnizim me inventar për laboratoron Kimi-Biologji	08.11.2021	€ 999.00	€ 992.00	€ 0.00	Pro Medical SHPK.
032	Shërbime rehabilitimi për familje të dëshmorëve në banjë	05.11.2021	€ 990.00	€ 950.00	€ 0.00	Banja e Kllokotit
033	Furnizim me drunjë dekoraiv për nevoja të komunës	08.11.2021	€ 990.00	€ 980.00	€ 0.00	Ideali shpk.
034	Shërbime të veçantë arsimtarve të gjuhës gjermane	12.11.2021	€ 990.00	€ 990.00	€ 0.00	Arlinda Livoreka
035	Shërbime të ngrohjes qëndrore në QKMF-në	12.11.2021	€ 990.00	€ 990.00	€ 0.00	Faruk Dernjani
036	Furnizim me goma për veturat e administratës komunale	12.11.2021	€ 950.00	€ 904.00	€ 0.00	Liman Bushi B.I.
037	Shërbime inxhinierike për nevoja të zyrës së urbanizmit	22.11.2021	€ 990.00	€ 990.00	€ 0.00	Adnan Lusnjani

038	Furnizim me TV për nevoja të SHML."Dardania'	19.11.2021	€ 992.00	€ 989.93	€ 0.00	AZTECH SHPK.
039	Furnizim me folia me mbishkrim, fotografi për aktivitete të ndryshme, plastifikim i dokumenteve të ndryshme	25.11.2021	€ 995.00	€ 986.00	€ 0.00	Muhamet Dernjani B.I.
040	Furnizim me material ndërtimor për raste në nevoj	26.11.2021	€ 790.00	€ 751.00	€ 0.00	Sabedin Hasallari B.I.
041	Furnizim me frigorifer dhe shporet elektrik për nevoja të Çerdhes	30.11.2021	€ 800.00	€ 790.00	€ 0.00	Fatime Curri B.I.
042	Furnizim me mekanizma për hapje dhe mbyllje të dritareve	05.12.2021	€ 430.20	€ 430.20	€ 0.00	KRAS SHPK.
043	Servisimi i veturave Dacia	22.12.2021	€ 810.00	€ 718.18	€ 0.00	AUTO MITA
044	Furnizim me notesa dhe kalendar për nevoja të Komunës	20.12.2021	€ 995.00	€ 989.50	€ 0.00	Muhamet Dernjani B.I.
045	Riparimi i autoambulances VW T5	20.12.2021	€ 800.00	€ 790.00	€ 0.00	SHPEND SEJDIU B.I.
			€ 37,190.35	€ 36,570.48	€ 0.00	
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA					36,570.48	

Procedurat me vlera mbi 1,000.00 € = 414,910.24 €

Procedurat me vlera nën 1,000.00 € = 36,570.48 €

Vlera e procedurave që janë zhvilluar me prokurim për vlerat mbi 1,000.00 € dhe nën 1,000.00 € janë 451,480.07 €.

Zyra e Prokurimit,
z. Xhevdet Bushi

ZYRA PËR TRANSPARENCË

Zyra e transparencës në përputhje me planin e aprovuar të veprimit për vitin 2021, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në kryerjen obligimeve në fushën e informimit publik sa më të mirë si të qytetarëve të komunës ashtu edhe opinionin sa më të gjerë për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zhvillimet në komunën tonë.

Në vazhdimin e aktiviteteve që kanë dalë nga këto obligime zyra e transparencës ka bërë informimet dhe njoftimet me kohë që dalin si obligime ligjore nga Rregullorja për transparencë, njoftimet me kohë për debate publike tematike, në të cilën janë propozuar për debat dokumentet e dala nga Kuvendi i Komunës. Përmes Sistemit të Teleprezencës e cila monitorohet nga MAPL-ja është bërë transmetimi i të gjitha seancave të Kuvendit të Komunës.

Zyra e transparencës ka informuar me kohë lidhur me aktivitetet e organeve të komunës së Hanit të Elezit duke raportuar mbi aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit si dhe punën e Kuvendit të Komunës dhe trupave të saja.

Rrethanat e krijuara me pandeminë e Koronavirusit kanë kushtëzuar që zyra e informimit të jetë pjesë edhe të njoftoj mbi aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Këshillin Komunal për zbatimin e masave parandaluese kundër COVID-19 në Komunën e Hanit të Elezit, Task Forca komunale për mbikëqyrjen e zhvillimit të procesit mësimorë në kushte të Pandemisë së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Zyra e transparencës ka qenë e angazhuar në të gjitha aktivitetet tjera kulturore dhe sportive dhe për të cilat ka informuar me kohë opinionin e gjerë.

Gjatë vitit 2021 kemi mbajtur debate publike të kryetarit të komunës dhe 2 dëgjime buxhetore si dhe 1 takim i rregullt i Kryetarit të Komunës me qytetarët.

Në vitin 2021 në komunën e Hanit të Elezit ka pasur shumë ngjarje dhe zhvillime të cilat zyra e informimit ju ka prezantuar qytetarëve të komunës sonë por edhe opinionit më të gjerë me informatat në faqen zyrtare në rrjetet sociale Facebook si dhe me shkrime në mjetet e tjera të informimit publik.

Vlen të theksohet se Faqja zyrtare e Komunës së Hanit të Elezit ka arritur numër shumë të mirë të lexueshëmëri duke arritur në mbi 65000 vizitorë individual me 159,463 vizita të realizuara.

Ndërsa faqja zyrtare Facebook gjatë vitit 2021 ka arritur në mbi 10000 përcjellës dhe për shkak të qasjes më të lehtë ka arritur lexueshëmëri shumë të mirë në informimin publik

Zyra e informimit ka qenë pjesëmarrëse në disa takime dhe tryeza pune, dhe komunikime online dhe konsiderojmë se është arritur prezantim i mirë i komunës sonë para opinionit të gjerë.

Në përputhje me Ligjin për qasje në dokumente publike 03/L-215 dhe udhëzimeve administrative përcjellëse, zyra për informim është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligjit dhe raportimin periodik dhe vjetorë të zbatimit të këtij Ligji në Zyrën e Kryeministrit. Në vitin 2021 komuna e Hanit të Elezit ka pasur 10 kërkesa për qasje në dokumente publike të cilat kanë marrë përgjigje në afatet e parapara ligjore.

Në fushën e teknologjisë informative zyra e transparencës është angazhuar në mirëmbajtjen dhe funksionimit të pajisjeve, sistemeve dhe aplikacioneve teknike për zbatimin në realizimin e projekteve në kuadër të E-qeverisjes.

Ky sistem ka mundësuar adresimin e saktë të dokumenteve dhe kërkesave drejtuar departamenteve përkatëse dhe në fund të vitit është përmbyllur me 9654 lëndë të cilat janë proceduar që të gjitha.

Sistemi i TI-së ka qenë plotësisht funksional dhe zyrtarët dhe qytetarët për as një moment nuk kanë mbetur pa shërbimet e nevojshme.

Qendra për Punë Sociale dhe Zyrës për Shërbimin e Pensionistëve, kanë qenë të kyqura pa pengesa në sistemin e intranetit të komunës që ka mundësuar që zyrtarët të kryejn shërbimet për qytetarë përmes aplikacioneve përkatëse.

Gjendje stabile e funksionimit të sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë informative dhe pa ndonjë problem, ka mundësuar funksionimin normal të të gjitha shërbimeve të nevojshme.

Gjatë vitit 2021 nga buxheti i komunës janë realizuar shpenzime për furnizime me pajisje të IT-së për të cilat janë vlerësuar si të nevojshme.

**Zyra për transparencë,
z. Bashkim Sopa**

ZYRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, FËMIJËVE DHE BARAZI GJINORE

1. Takimi mujor për Këshillin Komunal për Siguri dhe Bashkësi në Komunën e Hanit të Elezit i mbajtur më dt. 26.02.2021 ora 14:00.
2. "8 Marsi Dita e Gruas" më dt. 08.03.2021 për nderë të festës së Gruas Zyra për Barazi Gjinore në kuadër të kësaj feste ka mbajtur takim brenda institucionit të Komunës së Hanit të Elezit takim me të punsuarat gratë e institucionit dhe praktikantët-femra, me temë diskutimit rreth të drejtave të tyre dhe kërkesat e tyre rreth punës dhe veprës së tyre në institucion, ku po ashtu si pasojë e gjendjes me Covid-19 nuk kemi pasur mundësi të zgjerojmë rrethin në takim me gra të tjera jashtë institucionit komunal.
3. Më datë 12.03.2021 ish Presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga vizitoi Shkollën e Mesme të Lartë "Dardania" në Komunën e Hanit të Elezit për ligjerata motivuese nëpër Kosovë. Gjatë diskutimit ajo ndau me nxënësit, për mënyrën e depërtimit si grua në politikë dhe jo vetëm, për sfidat që hasin si gratë për nevojën dhe domosdoshmërinë për përfshirjen e grave në institucione vendimarrëse. Po ashtu ish presidentja pas vizitës së shkollës pati takimin edhe me Kryetarin ku njoftoj znj. Jahjaga me zhvillimet në komunën e Hanit të Elezit. Thëks i veçantë i bashkëbisedimit ishin investimet që komuna e Hanit të Elezit i ka realizuar në fushën e arsimit. Gjatë diskutimit, znj. Jahjaga e përgëzoi Kryetarin për punën e tij në Komunë si dhe për shërbimin e tij ndaj qytetarëve të Komunës. U bisedua edhe për projektet e tanishme të Komunës si dhe për nevojat që ka Hani i Elezit dhe qytetarët e saj.
4. Punëtori më dt. 26.03.2021 Organizata Joqeveritare- Sundimi i Demokracisë në Kosovë në bashkëpunim të ngushtë KKSBB-ën e komunës së Hanit të Elezit, organizon tryezë të përbashkët për projektin "Mobilizimi rinor për parandalim të hershëm të ekstremizmit" për të ofruar asistencë në hartimin e planit vjetor të veprimit të KKSBB-së, qëllimi është që ky plan veprimi të bashkëhartohet me pjesëmarrje të rinisë dhe ku do të i'u jepet më shumë rol rinisë edhe në implementim të aktiviteteve që ndërlidhen me luftimin e ekstremizmit.
5. Trajnim-Proceduar juridike për mbrojtjen e së drejtës kundër diskriminimit në Kosovë, përmes platformës Zoom (takim virtual) më dt. 01.02, dhe 06 Prill 2021 nga ora 10:00-15:00.
6. Takimi mujor i KKSBB-së i mbajtur më dt. 30.04.2021 nga ora 14:00.
7. Trajnim përmes platformës Zoom me temë "Diversiteti dhe Barazia në Republikën e Kosovës më datë 15 QERSHOR 2021 nga ora 10:30, dokumenti synon të matë perceptimin e përgjithshëm të popullatës në Kosovë lidhur me diversitetin në shumë aspekte të jetës së tyre, përfshirë ndikimin e pandemisë së COVID-19.
8. Takimi mujor i KKSBB-së më dt. 28.05.2021 nga ora 14:00.
9. Trajnimi i dytë më dt. 16.06.2021 me Organizatën Joqeveritare Sundimi i Demokracisë në Kosovë me temë diskutimi "Mobilizimi rinor për parandalimin e hershëm të ekstremizmit".
10. Takimi mujor i KKSBB-së më dt. 25.06.2021 nga ora 14:00.

Zyrtare për të drejtat e njeriut, kundër diskriminimit dhe të drejtat e fëmijëve

Znj. Vjosa Livoreka Rogaçi

ZYRA KOMUNALE PËR KTHIM DHE KOMUNITETE

Gjatë vitit 2021 zyra komunale për komunitete dhe kthim nuk ka pas kërkesa për raste të personave të riatdhesuar.

Gjatë muajit Janar-Dhjetor 2021 në zyrën për Komunitete dhe Kthim ka pasur (12) kërkesa për vërtetim për të paraqitur te zyra e punësimit.

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar **(12)** vërtetime për aplikim në Zyrën e punësimit për mbështetje nga programi i riintegritimit dhe për plan biznese individuale.

Nga 12 kërkesat të paraqitura në zyrën e punësimit nuk ka pasur ndonjë përfitues të ndonjë Organizate qoftë ndërkombëtare apo vendore të paraqitur me biznesplan apo ndonjë përfitues tjetër me pagë prej 170 € ku aplikimi ende është i hapur për persona të riatdhesuar nga MPB-UNDP, **kurse** Zyra e punësimit është e hapur për aplikim deri me datë:31.01.2022.

Gjatë vitit 2021 kam pasur edhe trajnim dy ditorë me datë: 11 dhe 12.11.2021 me temën “Riatdhesimi 2021 -Workshop për shëndetin mendor tek të riatdhesuarve” dhe shqyrtimi i Rregullores (QRK)

Nr.20/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

**Zyrtari i ZKKK-së,
z. Xhemshit Kalisi**

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme(shkurt. DAP) gjatë vitit 2021 ka kryer shërbime ndaj qytetarëve dhe organeve të tjera të komunës.

Shërbimet e përgjithshme të drejtorisë:

- Funksionimi i logjistikës duke përfshirë furnizimin e nevojshëm për transportin depon, postën, arkivin, shërbimin e sigurimit dhe mirëmbajtja e objektit, mirëmbajtja e autoparkut si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative dhe publikimin e informacioneve në faqen zyrtare.
- Dokumentet dhe aktvendimet e lëshuara nga kjo Drejtori janë të lëshuara në pajtim me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative sipas ligjit në fuqi.

RAPORTI I GJENDJES CIVILE PËR VITIN 2021

Lloji i dokumenteve	Numri i dokumenteve
Ekstrakt lindje	4166
Çertifikatë lindje	1076
Çertifikatë martese	981
Çertifikatë vdekje	242
Çertifikatë vendbanimi	372
Çertifikatë bashkësie familjare	647
Çertifikatë gjendje martesore	197
Çertifikatë shtetësie	53
Vërtetim nga arkivi	119
Totali	7853
Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror	241
	Numri
Lindje (Të rregullta dhe me vonesë)	89
Verifikime (me numër personal paraprak dhe me gjenerim të numrit personal)	83
Rishkrim Lindje	17
Regjistrim i qytetarit	22
Martesa (Të rregullta dhe jashtë vendit)	111
Rishikim Martese (Brenda dhe jashtë vendit)	65
Shkurorëzime	21
Me element të huaj (Bashkëshorti shtetas i huaj ose bashkëshortja shtetase e huaj)	55
Vdekje (Të rregullta dhe me vonesë)	43
Regjistrimi i qytetarit të vdekur	34

RAPORTI I QENDRËS PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE PËR VITIN 2021

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave	Përqindja
1	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	5,217	52.00
2	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	1,616	16.00
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1,243	12.00
4	Kryetari i Komunës	629	6.00
5	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	503	5.00
6	Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport	315	3.00
7	Kuvendi Komunal	147	1.00
8	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	108	1.00
9	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	63	0.00
10	Zyra e Prokurimit	59	0.00
11	Drejtoria e Politikave Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik	31	0.00
		9,931	

RAPORTI I DEPOS PËR VITIN 2021

Stoku në fund të vitit 2021	13,784
-----------------------------	---------------

Emërtimi	Numri
Furnizimet	22,938
Dalje nga Depoja	9,154

RAPORTI I AUTOPARKUT PËR VITIN 2021

	Numri i kërkesave
Kërkesa për vetura zyrtare	225 kërkesa
Kilometra të kaluara	105820 km
Karburante të shpenzuara	115,961 litra
Norma mesatare e shpenzimeve	8.6 litra

Nr	Vetura	Kilometra gjithsej	Derivate Naftë/ Benzinë	Shpenzime për 100km
1	<i>HYUNDAI I X35</i> 05Z-01-33	6,467	682	10.50
2	<i>HYUNDAI i20</i> 05Z-04-33	23,161	1,384	5.98
3	<i>TOYOTA PRADO</i> 05Z-05-33	5,119	762	14.80
4	<i>TOYOTA RUNER</i> 05Z-08-33	2,164	338	15.62
5	<i>TOYOTA RUNER</i> 05Z-15-33	2,032	308	15.16
6	<i>DACIA SANDERO LP</i> 01-549-	25,999	1,580	6.08

7	KIA SPORTAGE I RI 05-211-EJ	19,512	1,772	9.08
8	DACIA DUSTER I BARDH 05Z-10-33	10,812	1,062	9.82
9	DACIA DUSTER HIRI NR 05Z-11-33	9,308	896	9.63
10	DACIA DUSTER HIRI NR 05Z-12-33	11,267	1,076	9.55
11	AUTOBUS MAN 32 DYER 05Z-13-33	120	200	166.67
	Totali veturat e administrates	115,961	10,060	8.68
	Derivate për gjenerator dhe me autorizim	Naftë/L	Benzinë/L	Naftë/Benzinë-L
	GJENERATOR I KOMUNES	100.00		100.00
	DERIVATE ME AUTORIZIM NGA ADMINISTRATA	10.00	20.00	30.00
	Totali	110.00	20.00	130.00

SEKTORI I KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021

Numri i mbledhjeve të rregullta	Numri i mbledhjeve solemne	Numri i mbledhjeve të inauguruese	Numri i mbledhjeve të jashtëzakonshme
11	1	1	Nuk ka pasur

Emërtimi i dokumenteve sipas Protokollit	Numri i dokumenteve
Ftesa për mbledhje të kuvendit të komunë, KPF, KK, KAKSHMQS, KKZHEPUMM, KSHE, KPAK. ¹	57
Procesverbale të mbledhjeve të Kuvendit të Komunë , KPF, KK, KAKSHMQS, KZHEPUMM, KSHE, KPAK , debate publike.	60
Shkesa për pagesën e anëtarëve të kuvendit të komunës, KPF, KK, dhe për komitetet konsultative	56
Vendime të ndryshme	35
Plotësim ndryshim i rregullores	1

Emërtimi i dokumenteve për rishqyrtim të vendimeve	Numri i kërkesave për rishqyrtim
Vendim për shfuqizimin e vendimit me numër 01/Nr.8749/2021 për laptopët e stafit politik si asete të tyre	Dy (2)
Vendim për shfuqizimin e vendimit 01/Nr.9228/2020 për ndërrim destinim të tokës bujqësore z.Avdi Dernjani.	1

Komitetet	Numri i mbledhjeve
KPF - Shqyrtim i të gjitha materialet të cilat janë dërguar nga ekzekutivi i komunës dhe i ka përcjell për kuvend	10 mbledhje

¹ Shkurtesat spjegim:

KPF -Komitetit për politik e financa

KK - Komitetit për komunitete

KKAKSHMQS - Komitetit konsultativ për Arsim Kulturës Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

KZHEPUMM - Komitetit konsultativ Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

KKSHE - Komitetit konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

KKPAK- Komiteti konsultativ për Persona me aftësi të kufizuara.

KK - Shqyrtim i të gjitha materialet të cilat janë dërguar nga ekzekutivi i komunës dhe i ka përcjell për kuvend	10
KKAKSHMQS	6
KKZHEPUMM	6
KKSHE	6
KKPAK	6

SEKTORI I ARKIVIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021

<i>Numri i lëndëve të arkivuara</i>	<i>Numri i lëndëve të asgjësuar</i>	<i>Numri i dokumenteve</i>
2588	0	2891

**Drejtoreshë e drejtorisë për Administratë të Përgjithshme,
Znjsh. Natyra Kalisi**

Bilancet - shumat e zotimeve të papritura, ndarjeve buxhetore të pa alokuara, alokimet e pa zotuar dhe çfarëdo të ardhurash të një shume më të madhe se sa shuma e shpenzimeve dhe zotimet e papritura të bartura nga viti fiskal paraprak;

Organizatat Buxhetore - të gjitha ministritë, komunat, agjencitë dhe institucionet, të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Kosovës sipas këtij ligji;

Zotimet - shpenzimet e parashikuara, për të cilat urdhëresa për pagesë të zotimit është plotësuar në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit dhe të cilat janë regjistruar në SIMFK, pa marrë parasysh nëse i nënshtrohen apo jo ndonjë detyrimi ligjor;

Kategoritë e shpenzimeve - kategoritë “Pagat dhe Shtesat”, “Mallrat dhe Shërbimet”, “Shërbimet Komunale”, “Subvencionet dhe Transferet”, “Shpenzimet Kapitale” dhe “Rezervat”.

Viti fiskal - periudhën nga 1 Janari i një viti deri 31 dhjetor të vitit të njëjtë;

Alokimi i fondeve – shuma maksimale për zotime dhe shpenzime që mund të bëhet kundrejt ndarjeve specifike buxhetore, siç është përcaktuar me procedurat e parapara në nenin 34 të LMFP-së dhe të regjistruara në SIMFK;

Subvencionet – fondet e siguruar nga shteti për të ndihmuar kompanitë, personat juridik ose sektorët e veçantë të ekonomisë si për shembull bujqësia;

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve KASH– Është një dokument i prioriteteve të politikave të Qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërinë në procesin e buxhetit duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm makroekonomik dhe fiskal (zakonisht në një periudhë 3 vjeçare);

Të hyrat vetanake të komunave - çfarëdo e hyre e parasë publike e cila është vlerësuar dhe mbledhur nga komunat nga burimet e specifikuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108;

Burimet e financimit – grantet qeveritare (GQ), të hyrat vetanake (THV), të hyrat e dedikuara (THD), të hyrat nga AKP-ja dhe financimet nga huamarrja brenda deficitit buxhetor (FH);

Transferet - Çdo ndryshim i ndodhur brenda ndarjeve të aprovuara të paraqitura në tabelat 3.1, 3.1 A, 3.1 B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2 nënkupton transferet që janë:

- ndryshimi i shumave të ndara në mes të organizatave buxhetore,
- ndryshimet që ndodhin mes nën-programeve të po të njëjtës organizatë buxhetore dhe
- ndryshimet e ndodhura mes secilës kategori të shpenzimeve të paraqitur në tabelën 3.1, 3.1A, 3.1B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2.

Rialokimet - Çdo ndryshim i ndodhur në tabelën 3.2, 3.2B; dhe 4.2 në kategorinë e shpenzimeve kapitale brenda një nën-programi të një organizate buxhetore.

Hyrje

Raporti financiar për periudhën janar - dhjetor 2021, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe statutin e komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5.

Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës janar - dhjetor 2021. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore.

Performanca e të hyrave

Të hyrat vetanake kanë arritur vlerën e arkëtimit 325,140.90 euro apo 112.65% e planit duke pasur një rritje me 12.65% që korrespondon me 36,516.90 euro më shumë krahasuar me planin vjetor të parashikuar që ka qenë në shumë prej 288,624 euro.

Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore kanë arritur vlerën prej 2,634,463.47euro apo 98.33% e projeksioneve buxhetore të vitit 2021 që kanë qenë në shumë prej 2,679,093.81 euro, ndërsa në krahasim me shpenzimin e vitit paraprak kemi një rënie prej 17.18% apo 452,748.23Euro.

o **Shpenzimet për paga dhe shtesa**

Shpenzimet në këtë kategori ekonomike janë 1,645,045.11 apo 100.00 % në krahasim me ndarjen fillestare.

Bazuar në vendimet nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë ndar mjete shtesë për luftimin e Covid-19 në vlerën 42,174.50€; për shtesat mujore mbi pagën bazë.

- o **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 348,741.08 € arritur kështu normën e ekzekutimit 98.22% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori ose rritje prej 9.63% krahasuar me vitin 2020.
- o **Shpenzimet komunale** shënuan vlerën prej 64,899.87 € duke arritur kështu normën e ekzekutimit 99.69% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori ose rritje prej 4.53% më shumë krahasuar me vitin 2020.
- o **Shpenzimet për subvencione dhe transfere** arritën shumën prej 72,465.00 € duke arritur kështu normën e ekzekutimit 90.25% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori apo 115.20% më pak krahasuar me vitin 2020.
- o **Shpenzimet kapitale** arritën vlerën prej 503,312.41 € që paraqet një normë të lartë të ekzekutimit në 94.33% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori ose një rënie prej 80.73% më pak krahasuar me vitin 2020.

2. BUXHETI I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2021

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas ligjit me nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2021 ka qenë në lartësi prej **2,520,165.91Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa 1,602,780.91 €,
- Mallra dhe shërbime.....335,258.00 €,
- Shpenzimet komunale..... 67,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere ... 75,000.00 €,
- Shpenzime kapitale 385,127.00 €,
- Rezervat 55,000.00€,
- Totali i buxhetit.....2,520,165.91€.

Ndërsa buxheti përfundimtar është në shumë prej 2,686,554.11 €, që d.m.th. është rriturbuxheti edhe për 166.388.20€ duke përfshirë:

- Bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2020 në shumë prej 57,779.88€;
- Donacionet e pashpenzuara IPA FONDE të vitit 2020 në shumë prej 24,696.82 €;
- Donacioni nga DEMOS – për Ngritjen e performancën komunale, në shumë prej 41,687.00 €; këto mjete janë shfrytëzuar sipas marrëveshjes për projektin “Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit”;
- Bazuar në vendimet nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë ndarë mjete shtesë për luftimin e Covid-19 në vlerën 42,174.50€; për shtesat mujore mbi pagën bazë .

PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2021 SI DHEKRAHASIMI 2021/2020

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2021	Shpenzimi 2021	%	Buxheti 2020	Shpenzimi 2020	%
Paga dhe shtesa	1,645,045.11	1,645,045.11	100.00%	1,584,766.70	1,577,266.70	99.53%
Mallra dhe shërbime	355,065.39	348,741.08	98.22%	436,366.99	382,355.03	87.62%
Shpenzime komunale	65,100.00	64,899.87	99.69%	62,000.00	61,959.21	99.93%
Subvencione dhe transfere	80,290.00	72,465.00	90.25%	161,240.87	155,945.50	96.72%
Shpenzime kapitale	533,593.31	503,312.41	94.33%	1,033,093.21	909,685.26	88.05%
Rezervat			0.00%		-	0.00%
TOTALI	2,679,093.81	2,634,463.47	98.33%	3,277,468.59	3,087,211.70	94.20%

Komente dhe shpjegime:

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për vitin 2021 është në shumë prej **2.634.463.47€ apo 98.33%.**

Sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për:

- Paga dhe shtesa janë shpenzuar 1,645,045.11€ apo 100.00 %,
 - Mallra dhe shërbime 348,741.08€ apo 98.22 %,
 - Shpenzime komunale 64,899.87 € apo 99.69 %,
 - Subvencione dhe transfere 72,465.00 € apo 90.25 % dhe
 - Shpenzime kapitale 503,312.41 € apo 94.33 %.
- Shpenzimet për kategorinë Paga dhe shtesa për vitin 2021 janë më të larta për 4.12 % apo 67,778.41 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2020;
- Shpenzimet për kategorinë Mallra dhe shërbime për vitin 2021 janë më të ulëta për 9.63% apo 33,613.95 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2020;
- Shpenzimet për kategorinë Shpenzime komunale për vitin 2021 janë më të larta për 4.53 % apo 2,940.66 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2020;
- Shpenzimet për kategorinë Subvencione dhe transferet krahasuar me vitin 2020 janë më të ulëta për 115.20 % apo 83,480.50 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2020;
- Shpenzimet për kategorinë Shpenzime kapitale për vitin 2021 janë më të ulëta për 80.74% apo 406,372.85 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2020;

- Gjithsejtë shpenzimet për vitin 2021 për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve janë më të ulëta për 17.18% apo 452,748.23 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2020.

RAPORTI I KONTROLLIT BUXHETOR PËR VITIN 2021

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Alokimi	E paalokuar	Shpenzimi	Zotim /Obligimet në pritje	Mjetet e lira	Progresi %
CAT / RESP / PCLASS / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
04 FINANCIMET NGA HUAMARRJET	6,156.63	6,156.63	0.00	6,156.63	0.00	0.00	100.00%
659 HANI I ELEZIT	6,156.63	6,156.63	0.00	6,156.63	0.00	0.00	100.00%
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	6,156.63	6,156.63	0.00	6,156.63	0.00	0.00	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	6,156.63	6,156.63	0.00	6,156.63	0.00	0.00	100.00%
10 BUXHETI	2,260,149.48	2,260,149.48	0.00	2,253,664.36	6,102.88	382.24	99.71%
659 HANI I ELEZIT	2,260,149.48	2,260,149.48	0.00	2,253,664.36	6,102.88	382.24	99.71%
16035 ZYRA E KRYETARIT	100,200.41	100,200.41	0.00	100,200.41	0.00	0.00	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	77,200.41	77,200.41	0.00	77,200.41	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	23,000.00	23,000.00	0.00	23,000.00	0.00	0.00	100.00%
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	196,305.87	196,305.87	0.00	196,226.94	63.50	15.43	99.96%
11 PAGA DHE SHTESA	92,332.87	92,332.87	0.00	92,332.87	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	60,105.00	60,105.00	0.00	60,026.07	63.50	15.43	99.87%
14 SHPENZIME KOMUNALE	43,868.00	43,868.00	0.00	43,868.00	0.00	0.00	100.00%
16935 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL -	64,211.38	64,211.38	0.00	64,211.38	0.00	0.00	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	59,211.38	59,211.38	0.00	59,211.38	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00	0.00	100.00%

17535 BUXHETI - HANI ELEZIT	52,832.65	52,832.65	0.00	52,819.02	0.00	13.63	99.97%
11 PAGA DHE SHITESA	49,832.65	49,832.65	0.00	49,832.65	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	3,000.00	0.00	2,986.37	0.00	13.63	99.55%
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	179,981.19	179,981.19	0.00	179,938.27	42.23	0.69	99.98%
11 PAGA DHE SHITESA	65,316.19	65,316.19	0.00	65,316.19	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	53,000.00	53,000.00	0.00	52,959.50	40.03	0.47	99.92%
30 PASURITË JOFINANCIARE	61,665.00	61,665.00	0.00	61,662.58	2.20	0.22	100.00%
19675 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE	7,156.04	7,156.04	0.00	7,082.14	0.00	73.90	98.97%
11 PAGA DHE SHITESA	6,656.04	6,656.04	0.00	6,656.04	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	426.10	0.00	73.90	85.22%
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI	32,822.43	32,822.43	0.00	32,818.90	0.00	3.53	99.99%
11 PAGA DHE SHITESA	29,322.43	29,322.43	0.00	29,322.43	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,500.00	3,500.00	0.00	3,496.47	0.00	3.53	99.90%
48035 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - HANI ELEZIT	24,632.46	24,632.46	0.00	24,583.46	0.00	49.00	99.80%
11 PAGA DHE SHITESA	22,632.46	22,632.46	0.00	22,632.46	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,000.00	2,000.00	0.00	1,951.00	0.00	49.00	97.55%
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	174,087.87	174,087.87	0.00	168,560.73	5,527.14	0.00	96.83%
11 PAGA DHE SHITESA	51,595.87	51,595.87	0.00	51,595.87	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA	6,000.00	6,000.00	0.00	6,000.00	0.00	0.00	100.00%

DHE SHËRBIME							
30 PASURITË JOFINANCIARE	116,492.00	116,492.00	0.00	110,964.86	5,527.14	0.00	95.26%
38 REZERVAT	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
73044 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	16,749.28	16,749.28	0.00	16,748.28	0.00	1.00	99.99%
11 PAGA DHE SHITESA	16,254.28	16,254.28	0.00	16,254.28	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	495.00	495.00	0.00	494.00	0.00	1.00	99.80%
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	362,979.38	362,979.38	0.00	362,976.57	0.14	2.67	100.00%
11 PAGA DHE SHITESA	265,910.38	265,910.38	0.00	265,910.38	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	65,719.00	65,719.00	0.00	65,716.25	0.14	2.61	100.00%
14 SHPENZIME KOMUNALE	6,350.00	6,350.00	0.00	6,349.94	0.00	0.06	100.00%
30 PASURITË JOFINANCIARE	25,000.00	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00	0.00	100.00%
75671 SHËRBIMET SOCIALE	24,081.34	24,081.34	0.00	24,076.28	0.00	5.06	99.98%
11 PAGA DHE SHITESA	20,281.34	20,281.34	0.00	20,281.34	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,800.00	2,800.00	0.00	2,794.94	0.00	5.06	99.82%
14 SHPENZIME KOMUNALE	1,000.00	1,000.00	0.00	1,000.00	0.00	0.00	100.00%
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	113,930.25	113,930.25	0.00	113,725.88	196.62	7.75	99.82%
11 PAGA DHE SHITESA	35,595.25	35,595.25	0.00	35,595.25	0.00	0.00	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	25,000.00	25,000.00	0.00	24,795.99	196.62	7.39	99.18%
30 PASURITË JOFINANCIARE	53,335.00	53,335.00	0.00	53,334.64	0.00	0.36	100.00%

Sa i përket shfrytëzimit të tokës pronë e Kuvendit të Komunës si dhe shfrytëzimit me qira të objektit banesor (ndërtesa e të vetmuarve) po ashtu pronë Komunale nuk ka asnjë ndryshim në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Edhe më tutje janë 23 shfrytëzues me kontratë të tokës pronë e Kuvendit Komunal (ku janë të vendosura kryesisht lokalet me karakter të përkohshëm, garazhe etj.) si dhe gjashtë shfrytëzues të objektit banesor (banesa e të vetmuarve-pesë prej tyre për qëllime të banimit dhe njëri për lokal). Sipërfaqja e përgjithshme e tokës të dhënë me qira është 424.8m² ndërkohë sip. e banesave të dhëna me qira është 392.5m². Faturimi vjetor për shfrytëzuesit e pronës Komunale (tokës dhe banesave) është 6,042€. Përndryshe vitin 2021, Drejtoria ka inkasuar në emër të taksës për shfrytëzim të pronës Komunale shumën prej 5,920 € që është për 4.6% më pak se periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Të hyrat e Komunës nga shfrytëzuesit e tokës pronë Komunale 2021.

Emërtimi	VITI 2020	VITI 2021	Ulja në %
Të hyrat nga qiraja	6,197 €	5,920 €	4.6%

M
BR
OJ

TJA E MJEDISIT

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë bërë inspektime të rregullta nga inspektorja e mjedisit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje sipas legjislacionit në fuqi. Sektori i Mjedisit në vazhdimësi ka monitoruar ndotjen nga “Sharrcem” dhe operatorët tjerë ekonomik dhe lidhur me këtë do të përgatitë një informatë të veçantë Kuvendit të Komunës.

Për shkak të Covid 19 dhe si pasojë e ndalimit të tubimeve Komuna nuk ka shënuar ditën ndërkombëtare të Tokës, të Mjedisit si dhe aktivitete të tjera të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit. Në muajin shtator është shënuar java Evropiane e lëvizshmërisë me një aktivitet (lëvizje me bicikleta) të organizuar nga MMPH dhe Komuna.

Sektori i Mjedisit së bashku me MMPH ka bërë dhe identifikimin e deponive ilegale dhe në bashkëpunim me kompaninë NPL “Pastrimi” është bërë eliminimi i tyre.

Po ashtu, në periudhën raportuese sektori i mjedisit ka lëshuar 2 pëlqime mjedisore dhe ka realizuar të hyra në shumë prej 1,968.56€.

Të hyrat e sektorit të Mjedisit për vitin 2021 dhe krahasimi me vitin 2020

Emërtimi	VITI 2020	VITI 2021	%
Të hyrat nga gjobat mandatore	240 €	-	
Të hyrat nga pëlqimet e dhëna mjedisore	2,682 €	1,968 €	
Gjithësejt të hyrat	2,922 €	1,968 €	-48.4%

KA
DA
ST
RI

Si pasojë e veprimit të pandemisë covid 19, edhe vitin 2021 është shënuar ulje e kërkesave të qytetarëve për shërbime të ndryshme kadastrale. Ky numër i kërkesave është më i vogël për 239 lëndë apo 15.7% më pak se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Vitin 2021, kadastrit ka përfunduar gjithsejtë 1516 lëndë dhe ka realizuar të hyra në shumë prej 14,878€ apo 33.9% më shumë se vitin paraprak.

Të hyrat e sektorit të kadastrit për vitin 2020 dhe krahasimi me vitin 2019

Emërtimi	VITI 2020	VITI 2021	%
Numri i lëndëve të kryera	1755	1516	-15.7%
Të hyrat e realizuara	11,103 €	14,878 €	+33.9%

TË HYRAT E DREJTORISË PËR VITIN 2021

Vitin 2021, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit ka realizuar të hyra në shumë prej 33,559 € ap 10.6% më shumë se vitin 2020.

Të hyrat e DUKMM për periudhën Janar-Dhjetor 2020

Emërtimi	VITI 2021
Taksa komunale për leje ndërtimi	8,328 €
Taksa komunale në emër të legalizimit	2,465 €
Te hyrat nga shërbimet kadastrale	14,878 €
Shfrytëzimi i pronës publike	5,920 €
Te hyrat nga sektori Mjedisit	1,968 €
Gjithsejtë D U K M M	33,559 €

**Drejtör i drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
z.Nexhmedin Daci**

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021 DSHMS ka pasur këto aktivitete :

- ✓ Takime të vazhdueshme me Ministrinë e Shëndetësisë,
- ✓ Marrëveshje për kryerjen e shërbimeve nga Kompania NPL Pastrimi,
- ✓ Dërgim i listës për prioritet në vaksinim kundër Covid-19: lista e punëtorëve shëndetësorë dhe lista e pacienteve me sëmundje kronike, dërgim në MSH (me kërkesë të MSH),
- ✓ Kërkesë për Islamic Relief World Wide, për vazhdim të marrëveshjes së bashkëpunimit edhe për vitin 2021,
- ✓ Furnizimi me barna dhe material shëndetësor nga MSH,
- ✓ Ndërprerje e kontrolleve mjekësore në pikën kufitare nga pandemia COVID-19,
- ✓ Pranimi i 500 testeve rapide për Covid-19,
- ✓ Dërgimi i listave për shtesat në COVID-19 në rrezikshmëri gjatë punës për punëtorët shëndetësorë,
- ✓ Takim me KFOR-in Polak, situata me Covid-19, nevojat,
- ✓ Kërkesë nga MSH për nevojat në QKMF: Autoambulancë, veturë, gjeneratorë,
- ✓ Përgatitja e orarit për gatishmëri për barnatoret që operojnë në komunën e Hanit të Elezit,
- ✓ Përgatitja e orarit të barnatoreve për kujdestari gjatë ditëve të diel dhe gjatë festave zyrtare,
- ✓ Rregullimi i shenjave orientuese për QKMF,
- ✓ Takim me MSH dhe përgjegjësit e njësive të vaksinimi rreth organizimit dhe procedurave për imunizim me vaksinën kundër COVID-19,
- ✓ Takim me Ministrinë e Shëndetësisë për situatën me COVID-19 dhe informatë rreth furnizimit dhe procesit të vaksinimi nëpër QKMF,
- ✓ Përgatitja e dhomës për vaksinimin në QKMF,
- ✓ Përrurimi i klasave për nëna dhe fëmijë nga AMC,
- ✓ Më datë 08.12.2021 kemi pranuar një donacion nga KFORI Italian me aparaturë mjekësore.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSESIS FAMILJARE DR”MENDUH KALOSHI “

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor QKMF “Dr.Menduh Kaloshi” ka kryer detyrat e zakonshme që i përkasin këtij institucioni.

▪ **Spektori i Mjekësisë Familjar**

Në Sektorin e Mjekësisë Familjare janë ofruar këto shërbime shëndetësore:

- Kontrolllet mjekësore për të gjitha moshat dhe gjinitë nga mjeku –(dy mjek/e), Orari 07:00^h 15:00^h
- Vizitat shtëpiake për të sëmurit paliativ (të palëvizshëm).
- Vizitat shtëpiake tek pacientët me COVID-19.
- Shërbimet laboratorike dhe RTG si dhe leximin e tyre.
- Shërbimet specialiste konsultative nga Pediatri dhe Internisti.
- Imunizimi – Vaksinimi.
- Shërbimet e triazhimit .
- Shërbimet mjekësore administrative – SISH (Sistemi i Informimit Shëndetësor) tani online.

Muajt	Kartoteka		Intervenime	
Viti	2020	2021	2020	2021
Janar	2862	1478	3515	3103
Shkurt	2455	1418	2782	2590
Mars	1979	2112	1979	2175
Prill	869	1735	1027	2496
Maj	974	1734	1352	1714
Qershor	1630	2219	1378	2393
Korrik	1609	1982	1368	2179
Gusht	1511	2414	1694	5053
Shtator	1707	1982	1376	2179
Tetor	1928	2417	1118	1830
Nëntor	1978	1832	1987	2685
Dhjetor	2003	1429	1028	1620
Totali	21505	21752	20604	30017

▪ **Sektori i shëndetit publik**

Analiza e të dhënave, sistematizimi dhe raportimi i rregullt kanë qenë objektivat e realizimit në Njësinë e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) .

Sektori i Vaksinimit ka kryer vaksinimin e rregullt të të gjitha grupmoshave, të dy gjinive sipas kalendarit të vaksinimit. Vaksinimin e rregullt i fëmijëve deri në moshën 19 vjeçare (sipas kalendarit të vaksinimit) dhe rastet e lëndimit me vaksinën Antitetanike mbi moshën 19 vjeçare.

Gjithashtu është duke vazhduar vaksinimi kundër COVID-19.

Muajt	Vaksinimi		Vizitat për Nëna dhe fëmijë	
Viti	2020	2021	2020	2021
Janar	70	54	47	66
Shkurt	47	153	35	55
Mars	50	162	16	66
Prill	00	42	00	62
Maj	86	43	45	52
Qershor	107	70	35	57
Korrik	66	45	53	53
Gusht	61	55	62	53
Shtator	208	68	60	73
Tetor	175	53	64	60
Nëntor	459	136	57	63
Dhjetor	629	336	58	62
Totali	1958	1217	532	722

▪ **Sektori Diagnostikues**

Gjatë kësaj periudhe për analiza Laboratorike dhe Rëntgenologjike janë siguruar material i domosdoshëm për punë, kështu që janë ofruar shërbime si kuantitative (sasiore), po ashtu edhe kualitative, (cilësore). Sigurimi i reagensëve për analiza laboratorike që janë mungesë në listën e barnave esenciale dhe sigurimi i disa medikamenteve dhe materialit shpenzues për mbulimin e shërbimeve shëndetësore janë siguruar nga buxheti komunal.

Përveç analizave të rregullta sektori i laboratorit vazhdon të kryej kryhen edhe këto analiza (CRP,TSH,T₃,T₄,HbA_{1C}).

Po ashtu janë kryer edhe testet serologjike për COVID 19 ku reagensët po ashtu janë siguruar nga DSHMS –ja. V Gjithashtu sektori laboratorit ka kryer edhe testet rapide ku reagensët janë siguruar nga Ministria e Shëndetësisë. Rastet e referuara për testim PCR për virusin Covid-19 nga QKMF, IKSHPK ka obliguar të keni edhe RTG.

Muajt	Laboratori		RTG-ja	
Viti	2020	2021	2020	2021
Janar	322	238	32	51
Shkurt	200	283	45	148
Mars	88	299	18	69
Prill	00	345	3	74
Maj	00	196	13	48
Qershor	173	306	47	82
Korrik	97	107	30	94
Gusht	155	363	30	128
Shtator	242	328	00	127
Tetor	231	322	35	80
Nëntor	132	208	86	40
Dhjetor	881	197	43	00
Totali	2521	3192	382	941

▪ **Sektori i Emergjencës**

Ky sektor ka ofruar shërbime 24/7, i cili ka qenë një nga prioritetet në organizimin, menaxhimin dhe furnizimin me medikamente dhe material shpenzues si: shiringa, gjilpëra, material për fashim. Për menaxhim të rasteve në këtë sektor shërbimet janë ofruar edhe jashtë QKMF-së, dhe rastet emergjente që iu referohen nivelit sekondar dhe terciar, sipas thirrjeve nga ana e pacientëve, po ashtu edhe zyrtarëve policor dhe institucioneve në menaxhimin e emergjencave.

Vizitat shtëpiake tek pacientët me COVID-19. DSHMS –së gjithashtu ka arritur të krijoj përveç linjës 194 dhe një linjë tjetër telefonike pa pagës për kërkim të ndihmës mjekësore dhe informacione falas me numrin (0800 15 550) numër ky i ekspozuar edhe në objektin e QKMF-s.

Muajt	Emergjenca		Vizitat shtëpiake	
Viti	2020	2021	2020	2021
Janar	1326	928	133	97
Shkurt	1222	1002	114	79
Mars	1210	1769	76	64
Prill	420	1625	25	55
Maj	479	1999	59	59
Qershor	850	1,531	76	62
Korrik	804	1034	52	52
Gusht	589	1957	104	49
Shtator	529	917	64	110
Tetor	998	1003	78	60
Nëntor	1001	1202	182	103
Dhjetor	997	1008	175	78
Totali	10425	13765	1138	868

▪ **Shërbimet në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Gorancë**

AMF Gorancë ka ofruar shërbime shëndetësore çdo ditë vetëm në ndërrimin e paraqitës dhe me mundësi vizitë të mjekut një- dy herë gjatë javës (të martën dhe të enjten).

Muajt	Kontrollet mjekësore		Intervenime		Vizitat Shtëpiake		Vizitat për Nëna dhe fëmijë	
Viti	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Janar	19	00	34	27	8	13	00	00
Shkurt	47	00	20	37	6	18	00	00
Mars	00	00	49	29	3	9	00	00
Prill	00	00	00	42	00	11	00	00
Maj	00	10	00	38	00	12	00	00
Qershor	00	00	8	27	3	7	00	00
Korrik	00	00	00	24	00	17	00	00
Gusht	00	00	00	39	00	12	00	00
Shtator	117	00	82	24	11	17	00	00
Tetor	18	00	59	31	3	11	00	00
Nëntor	00	00	44	10	10	7	3	00
Dhjetor	00	00	96	18	23	6	5	00
Totali	201	10	392	346	67	128	8	00

▪ **Shërbimet specialitike**

Shërbimi	2020	2021
Pediatri	2,040	710
Internistike	1,100	903
Totali	3,140	1613

▪ **Rastet e sëmundjes me - CA**

Lloji i sëmundjes	Nr i rasteve		Gjinia	
VITI	2020	2021	2020	2021
CA PULMO	0	0	F-1 M-5	F- 0 M-0
	0			
CA ENDOMETRIUM	1	1	F-1 M-0	F- 1 M-0
CA PROSTATES	0	0	F-0 M-1	F- 0 M-0
CA MAMAE	3	3	F- 4 M-0	F- 3 M-0
CA Faringitis	1	1	F- 1 M-1	F- 1 M-0
Ca Laringitis	1	1	F-0 M-1	F-0 M-1
Ca Rectum	1	1	F-1 M-0	F-1 M-0
Tu Cerebri	1	1	F-0 M-1	F-0 M-1
Totali	8	8	6 9	F- 6 M-2

▪ **Raporti vjetor i vaksinimit ANTI-COVID**

Muaji	Gjithsej			
	Nr. i vaks.	Gjithsej doza I	Gjithsej doza II	Gjithsej doza III
Prill	260	260	0	
Maj	197	197	0	
Qershor	646	384	262	
Korrik	866	398	468	
Gusht	1844	1500	344	
Shtator	2776	1308	1468	
Tetor	1247	164	1083	
Nëntor	381	156	225	
Dhjetor	431	249	171	11
GJITHSEJ	8648	4616	4021	11

Lansimi i projektit Klasat për Nëna dhe Fëmijë në QKMF"Dr Menduh Kaloshi" Hani i Elezit

Qëllimi i Qendrës është të mbështesë përmirësimin e kujdesit shëndetësor të ofruar për nënat dhe fëmijët në Kosovë përmes zhvillimit të planifikuar të një infrastrukture mbështetëse arsimore. Kjo infrastrukturë krijohet me qëllim të informimit dhe këshillimit të grave, nënave të reja për ndryshimet normale që ndodhin gjatë shtatzënisë, si dhe shenjat ose ndryshimet që mund të paraqesin rrezik, kujdesin e nevojshëm pas lindjes, ushqyerjen me gji, dhënien e kujdesit për të porsalindurin dhe duke siguruar informacionin e nevojshëm për imunizimin e fëmijëve. Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar mbi 110 këshillime dhe 20 ligjërata .

Krahasimi i rasteve me Ca dhe grupmoshat e prekura.

Lloji i sëmundjes	Nr i rasteve		Gjinia			
VITI	2020	2021	2020		2021	
CA MAMAE	0	1	F-0	M-0	F- 1	M-0
CA Pleure	1	1	F-1	M-0	F- 1	M-0
CA Pancreaticus	0	0	F-0	M-0	F- 0	M-0
Limfoma	3	1	F- 2	M-1	F- 1	M-1
CA malineoma malignum	1	1	F- 1	M-1	F- 0	M-1
Tu Cerebri	1	1	F-0	M-1	F-1	M-0
Totali	8	8	6	9	F- 4	M-2

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

1. Institucionet shëndetësore në KPSH janë të obliguara që të mundësojnë dhe përkrahin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë,

2. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është i obligueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë në KPSH, dhe zbatohet sipas plan programit, të aprovuar nga Odat e Profesionisteve Shëndetësorë,

3. Për zhvillimin e aktiviteteve, nga paragrafi 2 i këtij neni përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në Programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale dhe caktohen sipas Termave të Referencës të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë,

4. Financimi i ZHVP të profesionistët shëndetësor bëhet nga buxheti i QKMF-së dhe burime të tjera bazuar në aktet normative në fuqi.

Gjatë këtij viti janë organizuar këto trajnime për stafin shëndetësorë.

Nr	Tema	Ligjëruesi	Data e mbajtjes	Numri i Pjesëmarrësve	Numri i Ligjeratave
1	Pandemia SARSCov-19	Luljete Qajani	20.01.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
2	Roli dhe rëndësia e komunikimit të profesionistëve shëndetësor	Inf.Luljete Qajani	10.02.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
3	Abuzimi me antibiotik	Mrsc.Vlora Bela-Suma	12.05.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
4	Imunizimi dhe vaksinimi. Kalendari i vaksinimit.	Inf.Selvete Kiki	16.06.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
5	Trajtimi i I.M leximi i EKG-	Dr.Isa Berisha Inf.Besiane Bushi	08.09.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
6	Epilepsia –kujdesi te ata qet epileptike	Inf.Luljete Qajani	22.09.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
7	Dita Botërore Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave	Dr.Nejazi Luma	06.10.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
8	Konvulsionet te fëmijët e moshës 0-3 vjet	Dr Fadil Gashi Inf.Selevete Kiki	27.10.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
9	Autizmi	Inf. Luljete Qajani	11.11.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
10	Dita Botërore Kundër Diabetit-Përdorimi i insulines.	Inf. Luljete Qajani	25.11.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat
11	Hiv-AIDS	Inf. Luljete Qajani	16.12.2021	10-15 Infermierë	1 ligjerat

▪ **Barnatorja Qëndrore**

Insulinat (pacientët për periudhën Janar- Qershor 2021 - kanë qenë 289)

Nr.	Emri komercial	Numri I insulinav
1	Novorapid	38,100
2	Levemir	32,100
3	Novomix	259,200
4	Gensulin R	5,100
5	Human Comb	111,300
6	Bazal	900

Mungesat nga lista esenciale

Nr.	Emri gjenerik	Sasia	Verejtje
1	Oksigjen	720 L	
2	Lidocain amp. 1%	360	
3	Brufen sir.	1200	
4	Brufen tbl.	36000	
5	Aspirin tbl.	30	
6	Loratidin sir.	360	
7	Metformin tbl	42000	Vetem 1 muaj furnizim
8	Atropin amp.	12	
9	Diazepam gel.	60	
10	Fenobarbitol tbl.	1800	
11	Amikacin amp.	360	
12	Aminofilin amp.	600	
13	Amiodarone tbl.	360	
14	Cefalecin sir.	240	
15	Cefazolin tbl.	600	
16	Metronidazol tbl.	3600	
17	Bactrim tbl.	7200	
18	Amlodipin tbl.	9000	Vetem 1 muaj furnizim
19	Anti tetanus imunoglobulin	30	Vetem 4 muaj furnizim
20	Aqua destilata amp.	1200	
21	Anti D immunoglobulin	36	
22	Bisoprolol tbl.	25200	
23	Methyldopa tbl.	3600	
24	Atoris tbl.	18	
25	Omeprazol inj.	2400	
26	Ondasetron amp.	120	
27	Metoclopramide tbl.	10800	
28	Ergometrin amp.	60	
29	Salbutamol pika	120	
30	NaCl 0.9% te 500 ml	1500	
31	Ringer sol 500 ml	1200	
32	NaCl 0.9 % te 100 ml	2400	Vetem 1 muaj furnizim
33	Vat (pambuk)	240	
34	Role gaz	240	Vetem 3 muaj furnizim

35	Leukoplast (flastera)	360	
36	Ac. Boric	60	
37	Vazelin	120	Vetem 3 muaj furnizim
38	Diclofen gel	360	
39	Captopril tbl.	1800	
40	Gentian violet	60	
41	Glimepirid tbl.	18000	
42	Sisteme te infusioneve	6000	
43	Shiringa 10 ml	12000	
44	Shiringa 5 ml	2400	Vetem 1 muaj furnizim
45	Gjilpera 21 G	24000	Vetem 4 muaj furnizim
46	Gjilpera 23 G	6000	
47	Gjilpera 19 G	24000	Vetem 4 muaj furnizim
48	Kateter nr. 18	120	
49	Kateter nr. 20	120	
50	Carbamazepin tbl.	1200	
51	Kanilla 22 G	12000	
52	Cefalexin sir	60	
53	Chloranfenicol crem	180	
54	Synopen amp.	300	
55	Diclofen amp.	4800	
56	Dexametazon amp.	4800	
57	Furosemide amp.	9000	
58	Losartan tbl	1800	
59	Enalapril tbl	24000	Vetem 1 muaj furnizim
60	Piracetam amp.	600	
61	Prednisolon tbl.	300	
62	Insulin Novomix	1200	Vetem 2 muaj furnizim
63	Insulin Novorapid	390	Vetem 2 muaj furnizim
64	Insulin Bazal	150	Vetem 1 muaj furnizim
65	Insulin Rapid	30	Vetem 2 muaj furnizim
66	Insulin Levemir	240	Vetem 2 muaj furnizim
67	Insulin Human	570	Vetem 2 muaj furnizim

▪ **Donacione**

Emri gjenerik	Njësia	Sasia	Donatori
Atrox Tbl. 20 mg	Pako	50	MG MED Sh.p.k
Dezifektues	Litra	360	SHFMU „Ilaz Thaqi”

▪ **Trajnimet dhe aktivitetet**

Trajnimet e mbajtura Janar- Dhjetor 2021 – QENDRA KRYESORE E MJESKESISE FAMILJARE

1. Roli dhe rëndësia e komunikimit, aftësitë më të domosdoshme të komunikimit,
2. Pandemia SARS Cov-19,
3. Menaxhimi i Pandemisë COVID-19,
4. Etika profesionale dhe të drejtat e pacientit,
5. Cilësia në kujdesin shëndetësor,
6. Të drejtat e punëtorëve në vendin e tyre të punës.
7. Roli i OIK -dhe masat që ndërmerr OIK në rast të shkeljeve profesionale

	2020	2021
Të hyrat vetanake QKMF	4.754.20 euro	7.721.50 euro

PANDEMIA COVID-19

Për shkak të rrethanave nga Pandemia COVID 19 edhe gjatë këtij viti janë zhvilluar aktivitete të ndryshme:

- Bashkëpunimi me institucionet qendrore me qëllim të menaxhimit dhe informimit për gjendjen me koronavirus në komunën tonë,
- Janë evidentuar rastet pozitive dhe rastet e dyshimta të qytetarëve të komunës tonë,
- Të gjithë qytetarët të cilët janë identifikuar si të dyshuar se janë të infektuar me koronavirus janë testuar në QKMF “Dr Menduh Kaloshi” me teste **Serologjike** apo **Rapide**, dhe varësisht nga rezultati qytetarë janë këshilluar nga personeli mjekësor për veprimet e mëtejshme,
- Në kuadër të QKMF është duke vazhduar procesi i vaksinimit kundër koronavirusit sipas vendimeve dhe rekomandimeve të institucioneve qendrore gjegjësisht Ministrisë së shëndetësisë.

Teste serologjike:


Muajt	Totali	Pozitivi i kaluar	Negativ	Pozitiv aktual
Janar	394	161	174	60
Shkurt	264	101	120	43
Mars	283	119	112	51
Prill	227	102	70	55
Maj	103	59	36	8
Qershor	115	69	41	5
Korrik	27	13	12	2
Gusht	107	52	37	17
Shtator	372	249	59	59
Tetor	117	91	15	11
Nëntor	36	12	13	11
Dhjetor	5	2	3	00
Totali	2.045	1028	692	325

Statistikat vjetore të testimeve rapide

Muajt	Totali	Pozitiv	Negativ
Janar	00	00	00
Shkurt	00	00	00
Mars	60	14	52
Prill	130	39	93
Maj	12	00	12
Qershor	6	0	6
Korrik	3	3	0
Gusht	340	139	209
Shtator	904	54	856
Tetor	161	0	161
Nëntor	1	1	00
Dhjetor	20	00	00
Totali	1639	250	1389

Vaksinimi-Tabela 3

Moshë	Gjinia		Nr. i vaks.	Vaks. I		GJ I	Vaks. II		GJ II
	F	M		A. Z. I	Pfiz. I		A. Z. II	Pfiz. II	
Gjithsej	525	577	1102	407	433	840	173	89	262



Rezultatet e testimit dhe vaksinimit:

- Nga tabelat shihet se numri i qytetarëve të testuar me **Teste serologjike** që kanë filluar nga dhjetori 2020 janë testuar 1914 apo shprehur në përqindje është 20.36% e popullsisë, ndashtu edhe me **Teste Rapide** që ka filluar nga marsi 2021 janë testuar 216 qytetarë
- Nga rezultatet e këtyre dy llojeve të testimeve dhe duke u bazuar në rezultatet e testimeve të testimeve serologjike ku identifikohen personat të cilët e kanë qenë të infektuar me koronavirus dhe e kanë kaluar, atëherë në bazë të shpërndarjes së të testuarëve dhe mostra mbi 20% e qytetarëve janë testuar mund të themi se mbi 65% e qytetarëve të komunës tonë kanë qenë të infektuar me koronavirus apo e kanë kaluar koronavirusin.

Nga tabela për numrin e qytetarëve të vaksinuar deri në fund të dhjetorit 2021, numri i përgjithshëm është 1102 apo 11.72% e qytetarëve të komunës tonë janë vaksinuar kundër koronavirusit.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021 Qendra për Punë Sociale ka kryer detyrat e zakonshme që i përkasin këtij institucioni.

- ✓ Janë mbajtur trajnime Online dhe në prani fizike për Shërbime Sociale dhe për Skemën e Asistencës Sociale.
- ✓ Bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Gjykatat, Qendrat për Punë Sociale, Departamentin për Politika Sociale dhe Familjare, Shkolla, OSBE, OJQ, KFOR etj.
- ✓ Kemi vazhduar mbajtjen e mbledhjeve të Tryezave për Menaxhimin e Rasteve.
- ✓ Këtë vit kemi pasur një donacion nga një mërgimtar i cili ka dhuruar tek ne 5 karoca për Persona me Aftësi të Kufizuara dhe dy palë paterica, gjithashtu donacion nga Shoqata “Shqiptarët për Shqiptarët” kemi pranuar 4 karroca për Persona me Aftësi të Kufizuara, 3 mbajtëse dhe 2 palë paterica ku më pas ne kemi dorëzuar për persona në nevojë.
- ✓ Vlen të theksohet se në këtë vit kemi pasur një bashkëpunim të mirë me UNDP dhe në bashkëpunim me Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare si pasojë e pandemisë kemi shpërndarë kupona (në vlerë nga 70-80 euro për gjëra ushqimore dhe higjienike) për familjet në gjendje të vështirë ekonomike dhe si prioritet kanë qenë familjet me prind vetëshqyes, familjet me shumë fëmijë, familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara në familje etj.
- ✓ Kemi pasur një bashkëpunim me UNDP ku kemi fituar një projekt për riparimin e dritareve të objektit të QPS-së dhe rregullimin, mobilimin e arkivit të QPS-së.
- ✓ Kemi pasur një bashkëpunim me Asociacionin e komunave ku kemi fituar një projekt për hartëzimin social në komunën tonë.
- ✓ Edhe gjatë vitit 2021 kemi pasur angazhime në shpërndarjen e pakove ushqimore dhe veshmbathjeve për familjet nevojtare të dhuruara nga donatorë të ndryshëm ku bartës kryesor në përpilimin e listave dhe shpërndarjen e tyre kemi qenë ne zyrtarët e QPS-së
- ✓ Për shkak të Pandemisë Covid19 kemi pasur të pezulluar riaplikimin për ndihmë sociale.

SKEMA E NDIHMËS SOCIALE

Muaji	Nr. i familjeve përfituese		Arsyetimi
	2020	2021	
Janar	129	125	
Shkurt	127	131	Rikthim të lëndëve përshkak të problemeve teknike në muajin janar
Mars	127	135	
Prill	129	134	
Maj	128	132	
Qershor	126	131	
Korrik	122	126	Ndërprerje me arsyetimin e punësimit dhe mos-tërheqjes së pagesës nga posta
Gusht	122	128	
Shtator	122	129	
Tetor	122	129	
Nëntor	120	127	
Dhjetor	127	128	

Pasqyra tabelare për Skemën Sociale

Shërbimet	2020	2021
Numri i aplikuesve të rinj	20	20
Lëndët dërguar për Komision Mjekësor	57	38
Lëndë të refuzuara nga komisioni mjekësor	00	01
Lëndë të kërkuara për plotësim dokumentacioni nga mjeku	01	00
Lëndët e aprovuar nga Komisioni Mjekësor	56	37
Lëshim të kartonëve të ndihmës sociale	76	91
Verifikim të familjeve që kanë aplikuar dhe riaplikuar për ndihmë sociale	78	43
Riaplikime dhe aplikime për ndihmë sociale	146	185
Vërtetime që gjenden si shfrytëzues i ndihmës sociale	1	1

SHËRBIMET SOCIALE

Përshkrimi	2020	2021
Trafikim i qenieve njerëzore	0	0
Trajtim i rastit -përdorues i substancave narkotike	0	1
Propozim për regjistrimin të mëvonshëm të fëmijëve	0	1
Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe e veprimit	26	79
Propozimi Gjykatës themelore për besimin e fëmijëve	0	0
Përkujdesje institucionale e të moshuarve në shtëpi të moshuarve	1	1
Fëmijë me sjellje asociale, Të miturit në konflikt me ligjin	13	32
Vërtetim që nuk është shfrytëzues i ndihmave sociale	2	7
Dhunë në Familje	3	3
Sanim të marrëdhënieve bashkëortore	0	2
Mbikëqyrje e shtuar nga Organi i Kujdestarisë për të miturit	1	2
Aplikime për fëmijët me aftësi të kufizuara	3	4
Pagesa për Fëmijët me aftësi të kufizuar	12	13
Pagesa për Fëmijët në strehim familjar brenda familjes biologjike dhe jashtë familjes biologjike	9	7
Prindërit e aprovuar për adoptim vendor të fëmijut	1	1
Braktisje të fëmijut	1	0
Vërtetim për humbje të shtetësisë	2	5
Konstatime zyrtar	3	0
Përfaqësim në Gjykatë	0	1
Këshillime psiko-sociale	24	16
Kontaktim fëmijë-prind	3	0
Vizita familjare	66	50
Caktimi i kujdestarisë për të miturit	3	0
Fëmijët me forma të rënda të punës	1	0
Adoptim i fëmijës	0	1
Mbrojtje e viktimave dhe të miturve në stacion policor	17	26

Të hyrat vetanake QPS	2020	2021
	85 euro	208 euro

Gjatë këtij viti kryesisht kemi qenë të angazhuar rreth zbatimit të urdhërësive dhe vendimeve të Qeverisë nëpër të gjithë operatorët ekonomik lidhur me masat ndaj pandemisë së Covid - 19 dhe emergjencës së ndërlidhur të shëndetit publik. Bazuar në këto urdhëresa disa prej operatorëve ekonomik u është ndaluar veprimtaria deri në marrjen e vendimit tjetër nga Qeveria dhe disa të tjerëve ju është lejuar të ushtrojnë veprimtarinë duke marrë masa higjienike e parandaluese.

Zbatimi i Legjislacionit dhe akteve tjera në fuqi për luftimin e COVID 19	1847	Inspektime të realizuara në subjekte të ndryshme afariste , shkolla,njoftim me masat e Qeverisë ndaj pandemisë COVID-19 , inspektime me Policinë e Kosovës
Vendime për vetëizolim	292	Për personat pozitiv me COVID – 19 dhe anëtarët e familjes
Vendime për lirim nga izolimi – Covid - 19	289	Bazuar në raportet e I.SH.P
Pëlqime Sanitare	3	174.74€
Inspektime për duhan	40	Vërejtje për respektim të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

Drejtoreshë e drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
Znj. Kimete Kuka Hasallari

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Raporti përmbledhës i punës njëvjeçare në kuadër të drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencë ka për qëllim të raportimit për kryetarin e komunës, informimin e opinionit publik për punën e DSHPE-së për periudhën Janar -Dhjetor 2021. Ky raport është një raport përmbledhës dhe njëherit paraqet punën e përgjithshme të kësaj drejtorie të cilat në një formë apo tjetër kanë ndikuar në jetën e qytetarit .Të gjitha aktivitetet e poshtëshënuara janë realizuar në bashkëpunim të plot me kryetarin e Komunës dhe drejtorit tjera komunale.

Aktivitetet e drejtorisë:

Kontratat e realizuara nga DSHPE:

- Ndërtimi i rezervarit të ujit në fshatin Gorancë në vlerë prej **21,845.78 €** (i përfunduar)
- Rregullimi i ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale në vlerë prej **9,751.00 €** (i përfunduar)
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale në vlerë prej **7,979.90 €** (i përfunduar)
- Mirëmbajtja e kanalizimit (zhbllokimi i gypave të kanalizimit fekla) në vlerë **9,765.00 €** (në proces të përmbushjes së kontratës deri më 25.03.2022)
- Furnizimi dhe montimi me polic të shtrirë në fshatin Seçishtë në vlerë prej **960.00 €** (i përfunduar)
- Riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit në vlerë prej **4,723.00 €** (i përfunduar)
- Kryerja e pagesave për shërbimet ndaj kompanisë publike lokale të mbeturinave duke u bazuar në marrëveshjen të nënshkruar në mes komunës dhe kompanisë NPL Pastrimi Sh.a në vlerë prej **40,882.60 €** ku këto mjete janë marrë nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime fondi 10.(i përfunduar)
- Shpenzimet e varrimit 56 raste në vlerë prej 9,520.00 € janë paguar nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.
- Marrëveshja e nënshkruar në mes komunës Hanit të Elezit, CDI(community development initiatives) dhe kompanisë rajonale të ujësjellësit Bifurkacioni Sh.A- Ferizaj , për projektin me titull “**Rehabilitimi i fabrikës për trajtimin e ujit të pijshëm dhe rehabilitimi i rrjetit të sistemit të furnizimit me ujë në komunën e Hanit të Elezit**” ku në bazë të procedurave të tenderimit për ekzekutimin e punimeve është operatori ekonomik **K.N.T.SH.”TEUTA-M”sh.p.k** dhe çmimi total për kryerjen e punimeve është **453.137,27 €** ku në bazë të marrëveshjes së lartcekur të nenit 4.1 Komuna do t’i financoj të gjitha kostot e projektit mbi **300,000.00 €** që nënkupton **153.127.27€** janë obligim i komunës dhe ky obligim është kryer duke u bazuar në dy situacionet e sjellura për punët e kryera. Vlen të theksohet se opertaori i kontraktuar është në proces të realizimit projektit dhe data e përfundimit të projektit është 130 dit nga data e nënshkrimit të kontratës të datës 14.06.2021 .
- Vendosija e paneleve solare për objektin e komunës-donacion nga KFOR-i Italian ku vlera e këtij donacioni arrin shumën **10,000.00 €** ku kapaciteti i gjenerimit të këtyre paneleve është **10kw orë** dhe do të futen në përdorim pas nënshkrimit të marrëveshjes me KEDS-in për mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimit.

Përgatitjen e paramasave për projektet e lartshënuara,

- Mirëmbajtjen e drunjtëve dekorativ të qytetit ku përfshihet krasitja, pastrimi dhe spërkatja me insekticid me kompaninë e kontraktuar ,
- Inspektimet e rregullta të punimeve në teren bashkë me inspektorin e ndërtimit dhe drejtorin e DSHPE-së,
- Aktivitetet e ndërmarra për 11 Qershorin ditën e Çlirimit ,
- Mirëmbajtjen e rregullt të ujësjellësit publik të Dimcës,
- Takimet e rregullta me zyrtarët e CDI-së për rehabilitimin e ujësjellësit në Han të Elezit ,

- Ndërrimin e kapakëve të dëmtuar të kanalizimit fekal nëpër rrugët lokale dhe zëvendësimin e tyre me kapak të riinjë,
- Takime të ndryshme me KFOR-in Polak , Italian,
- Rregullimin dhe mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit ,
- Mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik nga kompania e kontraktuar,
- Përgatitjen e katër aplikacioneve për aplikim në fondin e Kosovës për efikasitet të energjisë për një sistem të përbashkët të ngrohjes qendrore për Objektin e Komunës, QKMF, Çerdhes për fëmijë dhe SHML “Dardania”ku nga katër (4) projektet e cekura, gjatë takimit me drejtorët e shkollave është vendosur që të përzgjedhet projekti “Riparimin e sistemit të ngrohjes në shkollën fillore “Ilaz Thaçi” në vlerë prej **15,050 EURO**
- Bashkëpunim të ngushtë me kompaninë lokale të mbeturinave “NPL Pastrimi Sh.a”,duke pas parasysh edhe mirëmbajtjen e rrugëve Verë-Dimër, mirëmbajtjen e hapësirave publike, varrezave të Dëshmorëve etj..
- Mirëmbajtjen e panove reklamuese dhe antenave për kryerjen e pagesave për shfrytëzimin e pronës publike duke u bazuar në rregulloren për taksa dhe tarifa administrative.
- Mirëmbajtjen e rrugëve lokale duke bashkëpunuar me policinë e Kosovës për kompanitë (betonjerkat) të cilat derdhen betonin nëpër rrugë gjatë transportimit,
- Përgatitjen e marrëveshjes për shërbime të energjisë (MSHE)
- Pranimin e donacionit Traktor me pajisje përcjellëse nga GIZ-I Gjerman si rezultat i garës për mjedis të pastër,
- Nënshkrimin e marrëveshjes me agjencionin për efikasitet të energjisë për ndërrimin e 300 trupave ndriçues dhe zëvendësimin e tyre me trupa ndriçues LED në vlerë prej 52.800 ku në këtë marrëveshje 13.200 do të participon komuna e Hanit të Elezit në kohëzgjatje prej 3 viteve (akoma e pa zbatuar).
- Pranimin e donacionit nga Kfori Polak dhe Italian për pajisjet e shtëpisë së zjarrëfiksëve ku vlera e donacionit arrijnë shumën 10.000 €.
- Shpimi i pusit të ujit te fabrika e ujit të Dimcës (donacion nga organizata e Kuvajtit)

INKASIMET SIPAS VITEVE

2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
11.834.10	6.369.50	12.322	12.785	9.435	14.920	9,602.50	9,782	12787	10,765	13,423.00€

Të hyrat nga veprimtari Taxi për vitin 2021	→→→→	240.00 €
---	------	-----------------

NJËSIA E ZJARRFIKSËVE DHE SHPËTIMIT

Aktivitetet:

2021	Nr. I daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. I daljeve Teknike	Nr. I shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rrejshme	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt .	tot	zj.	qyt .	tot
Janar	3	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	4	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	4	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	6	5	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik	4	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gusht	13	13	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtator	9	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Tetor	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhjetor	5	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	51	47	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0

SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Ketë vit ka pas inspektime të vazhdueshme në teren ku gjatë tërë vitit kanë qenë rreth 100 inspektime , në këto inspektime janë përfshirë , inspektimet në taksi , autobusë dhe kombibusë lokal , janë rregulluar disa prej shenjave të dëmtuara që kane qenë dhe disa prej tyre janë zëvendësuar me të reja. Gjithashtu përveç punës primare, inspektori i komunikacionit ka kryer edhe inspektime të vazhdueshme në teren në bashkëpunim me inspektoren sanitare të cilat inspektime janë kryer kryesisht nëpër subjekte afariste për pandeminë COVID 19.

Për vitin 2021 në komunën tonë kemi të regjistruara vetëm **07** taksi që janë të pajisur me leje pune duke krahasuar me vitin 2020 ku numri i tyre ishte 03 dhe kjo vjen si pasojë e pandemisë COVID 19.

Numri i taksive për vitin 2021 është 07 dhe të hyrat nga ky numër për këtë vit janë **240.00 euro**.

Në komunën tonë janë gjithsej 11 vendbanime ku 07 prej tyre janë të përfshira në transport publik dhe transport të veçantë të nxënësve . Në komunën tonë kemi gjithsej 07 vend parkime për transport publik ku 05 prej tyre janë të shenjëzuara.

AKTIVITETET NGA INSPEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë vitit 2021 inspektori i ndërtimit kryesisht është marrë me inspektimet e punimeve në teren gjatë realizimit të projekteve komunale si dhe inspektimet e lejeve ndërtimore në territorin e Hanit të Elezit. Gjatë vitit 2021 inspektori i ndërtimit ka realizuar 36 proces verbale dhe janë realizuar 20 leje ndërtimore ku gjatë inspektimeve është marrë (1) vendim për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimore si dhe ka realizur edhe punë të tjera me interes për drejtorin.

Drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë,

z. Arsim Dernjani

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Gjatë muajit janar kam pasur takim me përfaqësuesit e organizatës Socio Projekt 2 kemi nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim të ndërsjelltë me këtë organizatë për projektin “Grante për biznes”, takimet kanë vazhduar edhe në muajt në vazhdim. Nga ky projekt kanë përfituar grand për biznes 8 përfitues/e, po ashtu kam dalë në teren për shpërndarjen e paisjeve tek përfituesit.

Gjatë muajit Janar kemi aplikuar tek Minsitria e Zhvillimit Rajonal për investime kapitale me projektin “Shtrimi me kubëza betoni në zonat rurale dhe urbane” dhe kjo ministri ka miratuar kërkesën tonë dhe na ka mbështetur për këtë projekt me mjete financiare në shumë prej 50,000€.

Gjatë muajit mars kemi pasur takim me organizatën Women 4 Women për projektin “Mundësitë e përmirësuar të vetëpunësimit dhe punësimit – “I SEE” i kemi njoftuar qytetarët për të aplikuar dhe u kemi ndihmuar për plotësim të aplikacioneve për të aplikuar në këtë grand.

Nga minsitria e Zhvillimit Rajonal kanë qenë të ftuar të gjithë qytetarët e komunës tonë të aplikojnë për grante për biznes (Programi për Zhvillim Rajonal 2021), nuk kemi pasur mundësi të mbajmë takime me qytetarët për shkak të pandemisë, kanë qenë të njoftuar përmes web faqes së ministrisë dhe komunës të aplikojnë online, ne si drejtori i kemi ndihmuar qytetarëve se si të aplikojnë.

Në muajin Prill i kemi përgaditur dhe nënshkruar 303 akt vendime për subjektet afariste për vitin 2021.

Të hyrat gjatë periudhës janar-qershor 2021 janë në shumë prej **56.325.33 €**.

Në muajin maj kam përgaditur një urdhëresë me shkrim për zyrtarin Fari Shkreta për të dalur në teren në inspektim edhe pas orarit të punës për barnatoret për respektim të rregullores për përcaktim të orarit të punës. Kam pasur takime të shpeshta me ministrinë e punëve të jashtme dhe diasporës të cilet kanë kërkuar një databazë për bizneset e komunës dhe vendasit tonë që operojnë me biznese jashtë vendit. Kam qenë pjesë e grupit punues për Hartat Zonale kemi pasur takime që janë organizuar nga organizata Giz për krijimin e këtij dokumenti. Po ashtu kam qenë pjesë e grupit punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedisë PLVM 2021-2026.

Po ashtu kam pasur takime me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kolegjiun për Zhvillim Ekonomik, Agjencionin e Zhvillimit Rajonal RDA, Kforin Polak etj.

Kemi pranuar kërkesa dhe ankesa nga subjektet afariste, kto kërkesa janë shqyrtuar nga komisioni i kërkesave dhe ankesave.

Kemi plotsuar pyetsorë të ndryshem nga organizatat e huaja.

Gjatë muajit dhjetor në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik kemi pasur këto aktivitete:

Punëtorja “Draft Analiza tri (3) vjeçare për investimet kapitale të realizuara sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë 2018-2020”, e organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal MZHR dhe Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale KLGJ. Është realizuar në kuadrin e programit “Dialogu për komunat Europiane (DEM) dhe është mbështetur nga Amasada e Mbretërisë Norvegjeze në Kosovë.

Bashkëpunim me zyrtarët kemi mbledhur të dhëna për plotësimin e formularëve siç është ajo rreth ndikimit negativ që solli COVID. Ky formularë ishte prezantuar nga MAPL dhe UN-Habitat Kosova. Zhvillimi i një program-projekti për personat me aftësi të veçanta dhe personat me Sindormën Down, i cili ka të bëjë me vetëdijësimin e familjarëve të tyre edhe integrimin e tyre në tregun e punës në të ardhmen. Kemi pasur takim me KFOR-in polak, organizata te ndryshme etj.

Në Prishtinë mbajtëm takim me CBC Programme, ku u informuam më shumë rreth mundësive që shpalos ky program, mundësitë për aplikim të projekteve etj.

Po ashtu takim tjetër kishim me Islamic Relief Kosovo, ku së bashku me nënkryetarin shpalosëm disa problematika të komunitetit dhe ata shprehën gatishmëri për bashkëpunim.

Është bërë përfundimi i Planit të Punës për vitin 2022 po ashtu është përfunduar edhe Plani për ndarjen buxhetore për vitin 2022.

Po ashtu janë kryer edhe shërbimet të tjera që kanë në fokus bizneset si psh.: informata rreth regjistrimit të bizneseve, ndryshim emri të njësisë, aplikime të ndryshme etj.

Tek qendra e regjistrimit të bizneseve kemi 201 subjekte taksapagues në drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, kurse aplikime për regjistrim të bizneseve të reja gjatë vitit 2021 kemi pasur në total 33 kërkesa. Tek bizneset pasive kemi regjistruar një total prej 90 sosh. Aplikime për biznese të reja Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali	Gjinia
Regjistrim biznesi	Biznese individuale / B.I	17	33	-Biznese me pronare femra janë 09 biznese
Regjistrim biznesi	Biznese Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara / SH.P.K	16		-Biznese me pronar meshkuj janë 24 biznese

Aplikime për shuarje të bizneseve

Përshkrimi	Gjinia	Totali
Aplikim për shuarje të bizneseve	2 Biznese me pronare Femra 1 Biznese me pronar Mashkull	03

Aplikime për ndryshime në biznes

Përshkrimi I shërbimit	Totali
Kërkesë për informata	29
Kërkesë për ndryshimin e pronarëve/aksionarëve	08
Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	08
Kërkesë për ndryshim të adresës	04
Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar	04
Kërkesë për ndryshim të emrit tregtarë	02

Kërkesë për ndryshimin të bordit	02
Kërkesë për shuarje të njësisë	01
Kërkesë për certifikatë dublikat	01

Aktivitetet dhe të hyrat vetanake gjatë 2021 nga Koordinator i Inspektoratit

Gjatë vitit 2021 kemi pasur këto aktivitete ku I kemi paraqitur në mënyrë tabelare si më poshtë	
Inspektimet e bëra gjatë periudhës së paraqitjes së virusit Covid-19	90
Aktvendimet dhe shpërndarja e tyre	303
Faturat e lëshuara gjatë viti 2021	121
Faturimi për vitin <u>2021</u>	80.349.08
Inkasimi gjatë vitit <u>2021</u>	75.783.89
Përqindja e inkasimit për 2021	94%

Përshkrimi	<u>Viti 2021</u>	<u>Viti 2020</u>	<u>Diferenca</u>	%
JANAR	3.691.00 €	5.651.79 €	- 1.960.79 €	(34.69)
SHKURT	435.00 €	2.846.00 €	- 2.411.00 €	(84.72)
MARS	93.00 €	1.495.00 €	- 1.402.00 €	(93.78)
PRILL	40.440.00 €	- €	40.440.00 €	-
MAJ	7.052.80 €	106.00 €	6.946.80 €	6.553.58
QERSHOR	4.613.53 €	32.483.50 €	- 27.869.97 €	(85.80)
Totali	<u>56.325.33 €</u>	<u>42.582.29 €</u>	<u>13.743.04 €</u>	<u>32.27</u>

Përshkrimi	<u>Viti 2021</u>	<u>Viti 2020</u>	<u>Diferenca</u>	%
KORRIK	1.020.00 €	3.171.00 €	- 2.151.00 €	(67.83)
GUSHT	5.024.96 €	1.509.50 €	3.515.46 €	232.89
SHTATOR	911.00 €	2.210.10 €	- 1.299.10 €	(58.78)
TETOR	3.180.00 €	5.688.50 €	- 2.508.50 €	(44.10)
NËNTOR	3.712.30 €	2.795.20 €	917.10 €	32.81
DHJETOR	5.610.30 €	1.393.40 €	4.216.90 €	302.63
Totali	<u>19.458.56 €</u>	<u>16.767.70 €</u>	<u>2.690.86 €</u>	<u>16.05</u>

	56.325.33 €	42.582.29 €	13.743.04 €	
Totali I të	19.458.56 €	16.767.70 €	2.690.86 €	
hyrave 2021	<u>75.783.89 €</u>	<u>59.349.99 €</u>	<u>16.433.90 €</u>	<u>27.7%</u>

Drejtoreshë e drejtorisë për Zhvillim Ekonomik,
Znjsh. Majlinda Kaloshi

Për vitin **2021** kemi pasur disa aktivitete, duke filluar prej muajit janar deri në muajin dhjetor e ata janë:

- Kemi pasur konfiskime të druve me një sasi prej 66.60 m³ të gjitha janë shkarkuar në depo të komunës dhe janë përdorur për nxemjen e objektit të komunës .
- Nga rojtarët e pyjeve janë dorëzuar **174 fletëparaqitje** me një masë drusore prej 275.12m³ dhe në dëmin e llogaritur prej 13,145.29 euro, prej tyre janë 21 fletëparaqitje vepër **penale** dhe 153 fletëparaqitje **kundërvajtje** të gjitha janë dorëzuar në gjykata për procedura të mëtutjeshme.

Paraqesim në form tabelare krahasimin e fletëparaqitjeve të vitit të kaluar në periudhën e njëjtë të vitit 2020- 2021

Viti	2020	2021
Fletëparaqitje penale	6	21
Fletëparaqitje kundërvajtje	142	153
Gjithësej	148	174

Kultivimi - Gjatë vitit 2021 kemi pasur 10/ha pyllëzime të reja në teritorin e fshatit Krivenik-Fushë të Frashnit.

- **Pyjet private:** Në pyjet private kemi pranuar **72 kërkesa** për prerje të druve në tërë territorin e komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021, deri në 31 Mars ku kalon traseja e rrugës. Janë lëshuar **65** leje për prerje për 427.41m³ dru zjarri dhe 31.16m³ trupa teknik, gjithsej 458.57m³ dhe dru jashtë pyllit 427.50m³, janë paguar për shërbime shumë prej **1,866.55€**.

- **Vendimet Gjygsore:** Nga gjykata kemi pranuar **158** vendime ku prej tyre janë : 105 vendime pozitive , 51vendime pezullume , 2 negative. Sasia drurore 157.3m³ me vlerë 17872.32 euro.

- **Rrallimet paratregtare dhe pastrimet:** Në planin menaxhues për vitin 2021 janë paraparë 20 ha për trajtim, mirëpo nga ana e Agjencionit dhe Ministris së Mirëqenjës Sociale është reduktuar numri i punëtorëve dhe janë pranuar vetëm tre punëtor për krasitje të pyjeve të ulëta dhe ndihmë për shuarjen e zjarreve, ku janë rralluar **3/ha**.Punëtoreset janë pranuar prej muajin prill deri në muajin qershor dhe kanë punuar në njësinë menaxhuese **UJI I BARDHË** në zonën kadastrale të fshatit Puset e Nikës.

Në sektorin e bujqësisë për vitin 2021 për subvecione **direkte** nga Ministria kanë aplikuar **101 fermer** me 112 aplikacione në sektor të ndryshëm .

Subvencione: Nga Drejtoria Komunale e bujqësisë janë dhanë subvencione në disa sektorë dhe ata janë:

Në formë tabelare paraqesim përfituesit të subvencionuar nga Drejtoria e Bujqësisë në Komunën e Hanit të Elezit.

Kulturat	Numri i aplikusve	Sipërfaqe e mbjellur-nën 2/ha	Çmimi në/ €	Shuma/euro
Grurë	10	14.30/ ha	150/ha	2145.00
Serra	16	83.50 /ari	50/ari	4175.00
Mjedra	8	2.36/ ha	5/ari	1180
Lajthi	1	59/ari	5/ari	295
Gjithsej	35			7795.00

Kërkesat për ndrim destinimin e pronave private në DBPZHR për vitit 2021

-Gjatë vitit 2021 në DBPZHR janë pranuar 5 kërkesa për ndërrim destinimin e tokave bujqësore në atë ndërtimore dhe janë dhënë :

-**Tre(3)** vendime nga Kuvendi(kl.5-6) dhe **dy(2)** vendime nga DBPZHR(kl.7-8).

Panairi - Nga DBPZHR-ja ka pasur një njoftim për të gjithë ata fermer të cilet merren me prodhime bujqësore të marrin pjesë në **panair** për të shitur dhe reklamuar prodhimet e veta .

- Panairi është mbajtur me datën 15.08.2021 para ndërtesës së Komunës së Hanit të Elezit duke filluar nga ora 6.00 h në vendosjen e tendave dhe renditjen e produkteve bujqësore, ku në ora 10.00h është bërë hapja. Në panair kanë marrë pjesë përfaqësues nga **Sharrcemi**, nga **OJQ LAB**, **OJQ HANI**, zyrtar Komunal dhe qytetar nga Komuna jonë.

Kemi formuar 4 komisione dhe ata janë :

1. Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për prerje të druve në pyjet private,
2. Komisionin për ndërrimin e destinimit të pronave private,
3. Komisionin për shfrytëzimin e tokës publike,
4. Komisionin për verifikimin e pronave të mbjellura për subvencione Komunale.

Këto komisione kanë dalur në teren dhe kanë raportuar në drejtori për gjendjen faktike dhe janë përcjell për në Kuvendin Komunal dhe në komisione të tjera ku është kërkuar në afate sa më të shkurta për të plotësuar nevojat e qytetarëve.

Nga **OJQ LAB** me seli në Han të Elezit është bërë thirrje për aplikues në sektor të ndryshëm bujqësor nga data **30/04** deri më **31/05/2021** në këto sektor:

1. Bletari (sanduk),
2. Serra nga 500m² për prodhim të perim kulturave për dy përfitues,
3. Ide Inovative në sektorin privat,
4. Lajthi për mbjellje të fidaneve- 20 ari për një përfitues.

Zjarret: Gjatë vitit 2021 në territorin e Komunës së Hanit të Elezit nuk kemi pasur zjarre.

Të hyrat nga APK-ja për vitin 2021 kanë qen 1,866.55euro.

Drejtor i drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ,
z. Abdurraman Bushi